

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË KUKËS**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Kukës**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2013 deri më 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.98, datë 24.07.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 267/13 datë 24.07.2015, i ka rekomanduar z. Bashkim Shehu, Kryetar i Bashkisë Kukës, zbatimin e masave të mëposhtme:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje:** Bashkia Kukës nuk ka zbatuar e ka kundërshtuar rekomandimet e auditimit të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 523/10 Prot, datë 10.10.2013, dhe të rikërkua nga KLSH me shkresën nr. 1016/36, datë 30.6.2014, që ka sjellë si pasojë mos vjeljen, mosvënien e kërimit në rrugë ligjore të dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit nga keq menaxhimi i Njesisë, për 14 masa zhdëmtuese në vlerën totale prej **13,780,068 lekë** ndaj 11 subjekteve dhe 149 personave nga të cilat: për 14 masa zhdëmtuese me vlerën mësipërme, ka refuzuar pranimin e ekzekutimit për vlerën 8,044,893 lekë, (ose 58,4%), duke pranuar për ekzekutim vlerën 5,735,175 lekë ose 41,6%, prej të cilës: ka arkëtuar vetëm 692,055 lekë (ose 12%), duke mbetur pa arkëtuar 5,043,120 lekë (ose 88%).

Masat organizative nga 8 masa të rikërkua për zbatim ka plotësuar 3 ose 37,5% dhe nuk ka zbatuar 5 masa ose 62,5%. Mosveprime këto në kundërshtim me nenet 9 dhe 16 ligjit nr 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i shfuqizuar dhe aktualisht në kundërshtim me nenin 15, germa “gj”, ”j” dhe “k” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, që ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, të marrë masa, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 523/10 Prot, datë 10.10.2013 dhe të **rikërkua nga KLSH me shkresën nr. 1016/36, datë 30.6.2014.**

**2. Gjetje:** Bashkia Kukës për vitet 2013-2014 ka mangësi, pamjaftueshmëri pune e kapacitetesh, lidhur me ndjekjen e hapave për instalimin, vendosjen, zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, mbajtjen evidentimin e ndjekjen e dokumentacionit përkatës shprehur me:

Mungesa të dokumentacionit për hapat e ndjekur dhe instalimin e MFK lidhur me; - Mungon dhe nuk është përcaktuar dokumenti i “*Deklarata e Misionit, vizionit dhe i objektivave Themelorë të aktivitetit*”, dokument i cili do të pasqyroste në mënyrë të qartë, koncize, Misionin, Vizionin dhe në mënyrë të matshme e krahasueshme, treguesit kryesor të arritur për **objektivat themelor të aktivitetit** të Bashkisë Kukës për vitet 2013 dhe 2014;

-Mungon dhe nuk ka ndonjë dokument për analizën dhe raportimin e realizimit të treguesve të parashikuar dhe të monitoruar të objektivave themelor të aktivitetit për Bashkinë Kukës në secilin prej viteve 2013 dhe 2014; ekzistenca e të cilit do te

krijonte mundësinë, për audituesin por edhe për publikun, të dhënies së një opinioni, vlerësues lidhur me arritjen e objektivave për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe ndoshta dhe për periudha të mëparshme progresive;

- Bashkia Kukës nuk ka hartuar e miratuar një Dokument “Plan Strategjik të Zhvillimit Ekonomik“ (PSZHE), apo Strategji të përcaktuar, afat gjatë të miratuar për zbatim.

Bashkia Kukës për periudhën 2012 deri në vitin 2015 ka të miratuar me VKB nr. 46, datë 15.10.2012 një dokument të quajtur “Plan Veprimi të Bashkisë Kukës për periudhën 2012-2015”, dokument i cili tregon mungesën e tij, dhe nuk zëvendëson, mungesën e Planit Strategjik të Zhvillimit Ekonomik (PSZHE). Gjithashtu nuk ka në efikasitet, Planin e Përgjithshëm Vendor, megjithëse e ka hartuar atë dhe me një sere shkresash (nr. 975, datë 13.9.2011, nr. 766, datë 11.7.2012, nr. 1172, datë 19.12.2012, nr. 1173, datë 19.12.2012, nr. 1239, datë 15.9.2014, pra ende prej 3 vjetësh pret miratimin nga instancat përkatëse qendrore.

*Gjithashtu “Planit të Zhvillimit të Bashkisë Kukës” i mungojnë shifra totale e mbulimit me burimet e financimit të rakorduara, pra është i pambluar por dhe nuk mobilizon apo tregon për çdo njërin prej 3 viteve burimet nga buxheti i Bashkisë, nga Buxheti Qendror, nga Donatorët apo burime të tjera.*

Ekzistenca dhe trajtimi i këtyre elementëve të munguar do ta vlerësonin të qenit dhe ekzistencën Strategjive për Zhvillim Ekonomik.

Për pasojë mungesa e këtyre elementëve ka krijuar dhe pamundësinë lidhur me monitorimin dhe realizimin e tij, për faktin e thjeshtë të mungesës së treguesve (indikatorëve) që do të pasqyronin përmbushjen e funksioneve të kësaj NJQV-je në funksion të përmbushjes së qëllimit për rritjen e mirëqenies së komunitetit, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”.

Lidhur me “Planin e veprimit e Bashkisë Kukës për periudhën 2012-2015“ dhe me kapitullin VII “Matrica e Projekteve sipas Premtimeve të Kryetarit të Bashkisë”, nga auditimi konstatojmë përveç vlerësimit për hapin e ndërmarrë, konstatojmë mangësitë si; mungesa e mbulimit me burimet sipas shtrirjes kohore, prioritarizimi, monitorimi, korrektimi që kanë sjellë si pasojë dhe mungesën e dokumentimit ndjekjes dhe raportimit sipas viteve, dokumente të cilat mungojnë e nuk raportohen.

Mungojnë e nuk raportohen treguesit e monitorimit ndjekjes dhe raportimit të realizimit të Planit strategjik sipas matricave b, c, d, e, pra realizimi i treguesve të matricave: Matrica e Qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të planit; c. Matrica e zbatimit të planit; d. Matrica e prioritarizimit të projekteve; dhe e. Fishat e projekteve, për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe progresiv prej fillimit që ka sjellë si pasojë mungesën dhe mos kryerjen e korrektiveve dhe ndryshimeve eventuale nga monitorimi.

-Mungon “Strategjia e menaxhimit të risqeve” dhe “Regjistri i riskut” që pengojnë realizimin e objektivave kryesore njëkohësisht dhe në hartimin e zbatimit të Plan Buxhetit dhe Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit;

-Mungojnë përcaktimi nga titullari i procedurave të brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullive;

Mungojnë përshkrimi dhe miratimi i proceseve dhe veprimeve, lidhur ne qarkullimin e dokumentacionit shkresor, përfshirja dhe normimi e tyre në rregulloret përkatëse; mungesa këto në mospërmbushje të neneve 8, germa “e”,17,19-22 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“ shtojcat përkatëse 6, 7 etj, miratuar me urdhrin nr. 54, datë 15.7.2010 dhe të udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Gjithashtu në pikën 7, Kreu i III, shprehet bazuar në “... Planifikimin strategjik...”, dhe ...” krijimin e partneriteteve...”, por nuk përmend dhe as cilëson asnjë strategji të hartuar (afatmesme apo afatgjatë) apo dhe asnjë Plan strategjik.

Pra mungon Strategjia e Zhvillimit Ekonomik afatgjatë SZHE

Mangësi në dokumentacion të evidentimit, ndjekjes e raportimit;

Por gjithashtu, nuk ka ose nuk u paraqit ndonjë dokument për analizën dhe raportimin e treguesve të parashikuar dhe të monitoruar për realizimin e objektivave themelor të aktivitetit për Bashkinë Kukës në secilin prej viteve 2013 dhe 2014; ekzistenca e të cilit do të krijonte mundësinë, për audituesin por edhe për publikun, të dhënies së një opinionit vlerësues lidhur me arritjen e objektivave për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe ndoshta dhe për periudha të mëparshme progresive.

Ngritja dhe funksionimi i “Grupi i Menaxhimit Strategjik“(GMS), është i parregullt pasi nuk përcaktojnë funksione detyrat e afatet, raportimin etj,si dhe ka munguar nuk dokumentohet e raportohet puna e (GMS), Grupeve për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP), Drejtoritë e Menaxhimit të Programeve (DEMP) .

*Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm vitet 2012 dhe 2013 janë plotësuar në mënyrë të pasaktë me mungesa plotësimi të komponentëve dhe mungesa plotësimi në brendi, duke mos respektuar formën standarde me pasojë mosparaqitje me besueshmëri te realitetit për vendosjen dhe funksionimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) gjendje raportuese kjo në kundërshtim me Kapitullin e III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, nenet 19-24 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me orientimet e Manualit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të miratuar nga MF me Urdhër nr.54, datë 8.7.2010, dhe me udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011”Mbi Paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”.*

Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK për vitin 2012 dhe 2013, është plotësuar në mënyrë jo të plotë në rubrika, shpesh mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, me mangësi dhe pasaktësi në rubrikat e plotësuara,si dhe vlerësime me tepëri që tregon se pyetëtori nuk pasqyron me vërtetësi realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kundërshtim me nenet 17 dhe 29 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 18 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011.

### **Rekomandim:**

**a.**Bashkia Kukës të marrë masa për rritjen e kapaciteteve dhe ndjekjen e hapave për instalimin, vendosjen, zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe të

hartojë miratojë monitorojë e zbatojë dokumentacionin e munguar: **“Deklarata e Misionit, Vizionit dhe i Objektivave Themelorë të aktivitetit”, “Strategjinë dhe Planin Strategjik të Zhvillimit Ekonomik PSZHE” “Raportimin e realizimit të treguesve të parashikuar dhe të monitoruar të Objektivave Themelor të Aktivitetit”, “Strategjia e menaxhimit të risqeve” dhe “Regjistri i riskut”** që pengojnë realizimin e objektivave kryesore, hartimin e zbatimin e Plan Buxhetit; “Plani i Veprimi Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit”; dokumentim “Përcaktimi nga titullari i procedurave të brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsisë”; Përshkrimi dhe miratimi i proceseve dhe veprimeve, lidhur me qarkullimin e dokumentacionit shkresor, përfshirja dhe normimi në rregulloret përkatëse.

**b. Bashkia Kukës, kryetari të marrë masa për Ngritjen dhe funksionimin e Strukturave të MFK si “Grupi i Menaxhimit Strategjik”(GMS), dhe të strukturave të tjera si Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP), Drejtoritë e Menaxhimit të Programeve (DEMP) dhe të përcaktojnë qartësisht funksionet detyrat e afatet, raportimin dhe monitorimin etj, si dhe të kërkojë dokumentimin e raportimin e vazhdueshëm të punës së strukturave të mësipërme.**

**Rekomandim:** Bashkia Kukës me resurse, asete, pasuri të konsiderueshme për zhvillim të qëndrueshëm e progresiv, të marrë masa të hartojë Planin Strategjik SZHE të ri, pasi Planveprimi aktual i ka përfunduar afati, duke përfshirë **“Planin e Përgjithshëm Vendor” (PPV), (tashmë të pritur për miratim)** dhe përfshijë e marrë në konsideratë të gjitha resurset, veprimtaritë e aktivitetet e munguara dhe të papërfshira më parë (resurset bujqësore, pyjet, ujërat, florën, faunën, dhe aktivitetet e lidhura me to industrinë bujqësinë, peshkimin, turizmin, pylltarinë, gjuetinë etj. të hartojë, monitorojë e raportojë strategjitë e **Plan-veprimet afatmesme dhe vjetore**, mbi të cilat hartohen e zbatohen buxhetet përkatëse.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa të hartojë, përgatisë dhe raportojë **“Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm” dhe “Pyetësori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK”**, në mënyrë të plotë e të saktë për çdo rubrikë e komponent në përputhje standardet në forme e përmbajtje me synim paraqitjen e realitetit me besueshmëri maksimale dhe të përmbushjes të funksionit për ti shërbyer ndjekjes së hapave për instalimin, vendosjen, e zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit si dhe efikasitetit të **Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB)** në këtë Njësi Publike.

**3. Gjetje:** DAB Bashkia Kukës ka performancë të pamjaftueshme pune reflektuar në vendosjen aplikimin e SKB dhe mekanizmave MFK, me mungesë kapacitetesh audituesish të certifikuar, mangësi, pamjaftueshmëri në auditimet e kryera në periudhën 2013-2014 lidhur me **rregullshmërinë, zbatimin e standardeve të auditimit, gjetjet rekomandimet dhe administrimin dosjeve të auditimit pasi** nga auditimi me zgjedhje i 7 dosjeve të auditimit rezultojnë mangësi lidhur me thellimin dhe çuarjen deri në fund të çështjeve të audituara, formulimin e saktë të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve, mangësi pasaktësi në trajtimin përgatitjen formulimin dhe cilësimin e bazës mbështetëse ligjore e nënligjore të gjetjeve, trajtimin e sqarimeve dhe observacioneve të cilat kanë bërë sjellë përgatitjen e projektraporteve dhe

Raporteve final me cilësi të pamjaftueshme; mangësi në planifikimin e auditimit dhe në ndarjen e çështjeve ndërmjet anëtarëve të grupit të audituesve për çdo mision auditimi të angazhuar; mos administrim i rregullt i dokumentacionit të dosjeve lidhur me mungesën e inventarizimit me numër për çdo fletë dokumenti, dhe mos dorëzim i tyre në arkivë në fundviti pasi të jetë kryer auditimi i zbatimit të rekomandimeve, gjendje kjo; në moszbatim e shkelje të procedurave të auditimit të brendshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 24.4.2007”Për auditivin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 ”Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr. 9720”dhe me VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Manuali i Procedurave të Auditimit, për të cilat Struktura e DAB ka detyrimin dhe ka dhënë sigurinë,dhe transparencë për auditimet e kryera.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, Kryetari dhe DAB të analizojë pamjaftueshmërinë e performancës së punës Audituese në vitet 2013-2014 dhe të marrin masat për strukturimin e plotë të DAB, për vendosjen dhe aplikimin e SKB mekanizmave MFK, lidhur me *rregullshmërinë, në zbatimin e standardeve të auditimit, gjetjet rekomandimet dhe administrimin dosjeve të auditimit*, si dhe lidhur me thellimin dhe çuarjen deri në fund të çështjeve të audituara, formulimin e saktë të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve, trajtimin përgatitjen formulimin dhe cilësimin e bazës mbështetëse ligjore e nënligjore të gjetjeve, trajtimin e sqarimeve dhe observacioneve e rritjen e cilësisë në përgatitjen e projektraporteve dhe Raporteve final të auditimit, në planifikimin e auditimit dhe në ndarjen e çështjeve ndërmjet anëtarëve të grupit të audituesve për çdo mision auditimi të angazhuar; dhe të kryejë inventarizimin me numër për çdo fletë dokumenti, e të dorëzojë dosjet në arkivë në fundviti pasi të jetë kryer auditimi i zbatimit të rekomandimeve; me synim rritjen e performancës, efikasitetit dhe transparencës së punës së DAB.

**4.Gjetje:** Nga analiza e treguesve të buxhetit, u konstatua se: Shpenzimet dhe detyrimet ndaj të tretëve në fund të vitit 2014, janë në vlerën 134,490 mijë lekë, nga të cilat detyrimet për sigurimet shoqërore 48,855 mijë lekë, veprim i cili bie në kundërshtim nenin 12, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku specifikohet se: “Buxheti vendor është i balancuar” dhe UMF nr.2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe UMF nr.3, datë 17.01.2014, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014. Detyrimet e prapambetura në mbyllje të periudhave ushtrimore, kanë tendencë rritje nga viti në vit, e konkretisht, në fund të vitit 2012, në vlerë 77,858 mijë lekë, në fund të vitit 2013 në vlerë 110,727 mijë lekë dhe në fund të vitit 2014 në vlerë 134,490 mijë lekë.

**Rekomandim:**Të merren masa, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, ndaj kreditorëve,të rezultuara në fund të vitit 2014 në vlerën **134,490 mijë lekë**. Të bëhen ndryshime në buxhetin e bashkisë për balancimin e të ardhurave me shpenzimet.

**5.Gjetje:** Në totalin e shpenzimeve, peshë të konsiderueshme zënë shpenzimet për ndihmën ekonomike. Për vitin 2013 janë trajtuar mesatarisht 2122 familje, me fond 102,262 mijë lekë. Për vitin 2014 janë trajtuar mesatarisht 1876 familje me fond 97,873 mijë lekë. Shqetësues është fakti se, për vitin 2013, nga 4.260 familje, sipas të dhënave të gjëndjes civile, datë 31.12.2013, trajtohen me ndihmë ekonomike 2.122 familje ose 49.8% e familjeve. Edhe për vitin 2014 nga 4.531 familje, trajtohen me ndihmë 1876 familje ose 41.4% e tyre .

**Rekomandim:** Të analizohet gjendja me përparësi, për krijimin e mundësive ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për të ulur numrin e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike. Të ngrihen grupe pune për analizimin e kësaj gjendje të vështirë ekonomike dhe t' i bëhen prezent Këshillit Bashkiak, për të marrë masa efektive në bashkëveprim me të gjithë faktorët ndikues në këtë drejtim.

**6.Gjetje:** Si mangësi në zbatimin e buxhetit konstatohet se, gjatë vitit 2014, nuk janë bërë analiza për marrjen e masave dhe ndryshimet në buxhet, për rritjen e të ardhurave dhe pakësimin e shpenzimeve operative me qëllim që buxheti të mbyllet i balancuar me të ardhurat dhe shpenzimet vjetore, veprime këto në kundërshtim me kreun e V-të, neni 15, pika 5 e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, ku specifikon: “Çdo njësi e qeverisjes vendore miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet pa deficit dhe në përputhje me ligjin nr. nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” .

**Rekomandim:** Gjatë zbatimit të buxhetit të rishikohet aftësia likuiduese me programimin fillestarë të buxhetit të bashkisë dhe të bëhen ndryshimet në buxhet sipas parashikimit të realizimit të ardhurave të pritshme.

**7.Gjetje:** Evidenca Kontabile është e pa azhurnuar, pasi nuk janë kontabilizuar faturat e energjisë elektrike dhe për pasojë në bilancin e vitit 2013 nuk janë përfshirë e pasqyruar detyrimet ndaj “CEZ Shpërndarje” sh.a. në vlerën 11,147,128 lekë, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” .

**Rekomandim:** Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa dhe të kontabilizohen e pasqyrohen në bilanc të gjitha faturat për detyrimet ndaj të tretëve si dhe të kryqëzohen likuidimet me detyrimet ndaj të tretëve rast pas rasti.

**8. Gjetje:** Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara për periudhën e audituar janë rritur për marrjet në dorëzim të investimeve të kryera, por u konstatua mangësi se, disa objekte të regjistruar prej vitesh në kontabilitet, nuk janë rivlerësuar dhe mbartin vlera fillestare jo reale, e konkretisht :

1. “Lidhja e Prizrenit” me vlerë 1,054,200 lekë,
2. “Avni Rustemi” me vlerë 1,228,000 lekë,
3. “Bajram Curri” me vlerë 918,000 lekë,
4. Konvikti me vlerë 926,000 lekë.
5. Kopshti nr.1, me vlerë 560,000 lekë,
6. kopshti nr.2, me vlerë 293,000 lekë ,
7. Kopshti nr.5, me vlerë 317,000 lekë,
8. Çerdhe nr.2, me vlerë 200,000 lekë,
9. Çerdhe nr,5, me vlerë 713,033 lekë.

**Rekomandim:** Të merren masa, për vlerësimin e ndërtesave, me komisione dhe ekspert të fushës dhe të bëhen shtesat në kontabilitet për rritjen e vlerave fillestare të tyre.

**9. Gjetje:** Në administrimin e inventarëve që ju përkasin shkollave që janë në administrim të Bashkisë Kukës, u konstatuan si mangësi se, prej vitesh nuk është bërë rakordim midis Bashkisë dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Kukës, “Për inventarët dhe materialet e tërhequra nga drejtorët e shkollave”, dhënë nga Drejtoria Arsimore.

Sipas shkresës të Drejtorisë Arsimore Rajonale Kukës, nr. 909, datë 17.01.2014, drejtuar Bashkisë, specifikon se, për llogari të vitit 2013, i janë dërguar drejtorive të shkollave **752,220 lekë**, inventarë, pa kaluar nëpërmes të Bashkisë (magazinës).

Sipas shkresës të Drejtorisë Arsimore Rajonale Kukës nr.755, datë 15.01.2015, i është drejtuar Bashkisë se: “Për llogari të vitit 2014, nga Drejtoria Arsimore, janë furnizuar me inventare drejtorët e shkollave, në shumën **2,537,885 lekë**, pa kaluar nëpërmes të Bashkisë. Në të dy rastet nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Kukës, shkresat e bëra janë jashtë afatit (mbas mbylljes së viteve ushtrimore 2013 e 2014), kur duhej që rast pas rasti të vinte në dijeni Bashkinë.

Komisionet e inventarit që kanë kryer inventarizimin nëpër shkolla kanë rritur inventarin fizik sipas gjendjes në fakt, por meqenëse këto inventar nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë nuk janë përfshirë në kontabilitet. Kjo praktikë është ndjekur prej vitesh, duke mbartur pasaktësi midis gjendjes kontable dhe asaj fizike. Ndikim në pasaktësi ka dhënë dhe nxjerrja jashtë përdorimit e inventarëve të shkollave duke e pakësuar inventarin kontabël padrejtësisht ( të pa regjistruara në kontabilitet), në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, me UMF nr. 30, datë 29.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në sektorin Publik”.

**Rekomandim:** Të rakordohet me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Kukës, ku sipas të dhënave të inventarit fizik, të kryer nga bashkia në vitin 2014, në inventarin e shkollave janë mbartur, në llogarinë nr. 218, ”Inventarë Ekonomik” vlera 38,239,017 lekë dhe në llogarinë nr. 327, ”Objekte inventari” vlera 3,628,899 lekë. Të saktësohen të gjitha furnizimet e bëra nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Kukës dhe të nxirren diferencat, duke vënë para përgjegjësisë personat përgjegjës. Njëkohësisht të bëhen dhe sistemitet në kontabilitet nga bashkia, për barazimin e kontabilitetit me fizikun.

**10. Gjetje:** Sipas dokumentacionit të likuidimeve nëpërmes Degës së Thesarit Kukës, për vitet 2013 e 2014, nga Bashkia Kukës janë financuar në favor të “F....” SHA, **37,000 mijë lekë**. Urdhër shpenzimet me të cilat janë kryer likuidimet nuk kanë dokumente justifikues, nuk ka marrëveshje apo kontratë midis bashkisë dhe “F.... K...”SHA.

Nga bashkia nuk janë zbatuar procedurat e transformimit të klubit Sportiv në shoqëri aksionare, pasi mungon urdhri i kryetarit të bashkisë për fillimin e procedurës të transformimit si dhe emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar për verifikimin dhe vërtetimin e bilancit të çeljes së shoqërisë. Gjithashtu nga bashkia nuk disponohet raporti përmbledhës i komisionit për përcaktimin e kapitalit të shoqërisë.

Për financimin e bërë nga Aksionari Bashkia Kukës në shumën 21,000 mijë lekë për vitin 2013 dhe 16,000 mijë lekë për vitin 2014, nuk disponohen vendimet e marra nga bordi i aksionarëve për detajimin e shpenzimit të këtij fondi, dokumentet financiare, dokumentacioni justifikues për realizimin e shpenzimeve nga shoqëria. Mungon detajimi i detyrimeve të aksionarëve dhe kriteret ligjore mbi të cilat janë përcaktuar këto detyrime.

Sipas Ekstratit historik tregtar për të dhënat e subjektit “F.....K.....K” Sh.A., regjistruar më datë 08.09.2011, me kapital 6 000 mijë lekë, e përbërë nga tre aksionar me nga 2.000 mijë lekë, nuk është përfshirë Bashkia Kukës. Sipas nenit 7, të statutit të shoqërisë, bashkia nuk është përfshirë si aksionar. Referuar statutit të

shoqërisë aksionare,“F.....K...” Sh.A, datë 29.08.2011, neni 7,”Kapitali themeltarë”, nuk është e përfshirë si aksionare Bashkia Kukës.

Gjithashtu, është vepruar në kundërshtim me nenin 19, ”Klubet Sportive” pika 3, të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për Sportin”, ndryshuar me ligjin nr. 9816, datë 22.10.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9963, datë 21.07.2008, pasi është përcaktuar se: *Klubi sportiv i transformuar në shoqëri anonime gëzon të drejtën e përparësisë së përdorimit të objekteve sportive të institucionit publik,në bazë të një marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre.*

*Bashkia nuk ka marrëveshje të lidhur me “F...K...” SHA,veprime këto në kundërshtim me pikën 8,të VKM nr. 1718, datë 24.12.2008 “Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltarë” dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve“ e “Ministrisë Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës“, nr. 7066, prot.datë 01.10.2010 e nr. 8758, prot datë 25.10.2010. Përdorimi i këtyre fondeve pa kriter është në dëm të buxhetit të bashkisë që ka ndikuar në rritjen e detyrimeve ndaj të tretëve.*

**Rekomandim:** Të merren masa dhe të rakordohet me “F.....K...” SHA, për të saktësuar përqindjen e aksioneve të bashkisë, si dhe të lidhen marrëveshje edhe për përdorimin e objekteve sportive. Bashkia të kërkojë zyrtarisht raportin mbi përdorimin e fondeve nga shoqëria si dhe bilancin kontabël. Për financimin në shumën 37,000 mijë lekë, nga ana e bashkisë të nxirret përgjegjësia.

**11. Gjetje:** Në 4 tendera të zhvilluar me objekt: “Blerje ushqimesh”, me urdhër prokurimi nr.22, datë 22.04.2013, me fond limit 16.566.000 lekë, u konstatua se: Në dokumentet e tenderit, për mjetet e transportit nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportimin e tyre, nuk është përcaktuar se çfarë lloj mjeti duhet të paraqitet nga OE, për rrjedhojë OE i shpallur fitues për plotësimin e kësaj kërkesë, ka paraqitur vetëm mjetin autoveturë, i cili nuk përmbush kriteret. Në artikujt e kërkuar, për 14 prej tyre nuk janë dhënë specifikimet teknike, në disa prej tyre, në specifikimet teknike janë përcaktuar referenca e markave, në pjesën më të madhe të artikujve ushqimorë nuk janë përcaktuar standardet dhe cilësia e artikujve të kërkuar, objekt prokurimi, veprime në kundërshtim me nenin 23 “Specifikimet teknike” të ligjit “Për prokurimin publik”.

**Rekomandim:** Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, të marrë masa për plotësimin e saktë dhe të duhur të specifikimeve teknike.

**12. Gjetje:** Në 4 tendera të zhvilluar me objekt “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me urdhër prokurimi nr. 08, datë 25.11.2014, me fond limit 1.209.500 lekë, “Materiale për dekorin e Vitit të Ri 2014”: me urdhër prokurimi nr. 93, datë 01.12.2013, dhe fond limit 1.078.000 lekë, “Blerje materiale për koktejet e fundvitit 2014”, me urdhër prokurimi nr. 77, datë 18.12.2014 dhe fond limit 600.000 lekë, “Dekori i Vitit të Ri 2015”, me urdhër prokurimi nr.70, datë 10.12.2014 dhe fond limit 1.543.400 lekë rezultoi se: procedura e përzgjedhur e prokurimit “me negociim pa shpallje paraprake” është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenin 33, pasi AK nuk është në kushtet e kësaj procedure.

**Rekomandim:**Bashkia Kukës, të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e saktë te procedurës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e LPP.



**13. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë**”, me urdhër prokurimi nr. 08, datë 25.11.2014, me fond limit 1.209.500 lekë, u konstatua se: nuk ka asnjë argumentim për shtesën e kontratës në masën 20%, si dhe urdhër prokurimi. në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu IV, pika 5, “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, nënpika “b”.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të prokurimit publik duke i argumentuar ato.

**14. Gjetje:** Në 4 tendera të zhvilluar me objekt “Materiale për dekorin e Vitit të Ri 2014”: me urdhër prokurimi nr. 93, datë 01.12.2013, dhe fond limit 1.078.000 lekë, objekt “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me urdhër prokurimi nr. 08, datë 25.11.2014, me fond limit 1.209.500 lekë, “Blerje materiale për shërbime të ndryshme”, me urdhër prokurimi nr. 18, datë 24.06.2014 dhe fond limit 3.000.000 lekë, “Dekori i Vitit të Ri 2015”, me urdhër prokurimi nr. 70, datë 10.12.2014 dhe fond limit 1.543.400 lekë, rezultoi se preventivi nuk ka të dhëna se si kanë dalë çmimet për të cilat është llogaritur fondi limit, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu II, “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa për llogaritjen e fondit limit, sipas kërkesave të LPP.

**15. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje konteniere mbetjesh urbane**”, me urdhër prokurimi nr.10, datë 27.03.2013 dhe fond limit 3.000.000 lekë, rezultoi se: Kontrata nr.49, datë 26.06.2013, me vlerë 3.588.000 lekë, deri në periudhën e auditimit nuk është likuiduar dhe malli i paraqitur me faturë tatimore, deri në përfundimin e auditimit nuk është bërë hyrje, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa për menaxhimin e aktiveve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

**16. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje dru zjarri për vitin akademik 2013 -2014 për institucionet në varësi të bashkisë Kukës**”, me urdhër prokurimi nr. 69, datë 17.09.2013 dhe fond limit 3.300.000 lekë, rezultoi se: nuk ka asnjë dokumentacion për kërkesat sipas institucioneve, nuk ka përlllogaritje se si ka dalë fondi limit, (çmimet), në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu II dhe V. Në DT, nuk është përcaktuar dhe përshkruar mënyra e marrjes në dorëzim të druve të zjarrit (si mall specifik). Në zbatimin e kontratës nga ana e AK është lidhur kontratë shtesë për të cilën nuk disponohet asnjë e dhënë se çfarë sasive është dhe për kë institucion është (ku kanë lindur nevojat), nuk ka urdhër prokurimi nga ana e titullarit të AK për kryerjen e procedurave të prokurimit për shtesën në masën 20% të vlerës së kontratës, në kundërshtim me VKM, Kreun IV dhe V. Fletë hyrja është hartuar mbi 1 vit me vonë, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa për zbatimin e akteve ligjore, në llogaritjen e fondit limit, në hartimin e DT si, dhe në lidhjen e kontratave shtesë si dhe marrjen në dorëzim të mallrave specifik.

**17.Gjetje:** Në tre tendera të zhvilluar me objekt “**Mjedise sportive për 4 shkolla 9 vjeçare (Ndërtim palestre sportive)**”, me urdhër prokurimi nr.45, datë 23.07.13 dhe fond limit 25.828.331 lekë, rezultoi se: nuk ka asnjë urdhër të titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, projekteve e preventivit për llogaritjen e vlerës së kontratës, në kundërshtim me VKM nr.1 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “Zhvillimi i Procedurave”, pika 2. Llogaritja e fondit limit dhe prevenivi për shkollën 9 vjeçare “Lidhja e Prizerenit”, është hartuar në nëntor të vitit 2009, dhe **nuk është përditësuar në periudhën e daljes së urdhër prokurimit**. Nuk është respektuar VKM nr.568, datë 27.6.13, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, duke sjellë për pasojë llogaritjen e fondit limit për këtë objekt për më shumë në shumën **+1.020.609 lekë**. Në të tre preventivat nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.08.2007, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, mbi sigurinë në kantier, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit.

Në DT, për makineritë është vendosur kushti që *Prioritet kane operatore ekonomik që kanë mjetet në pronësi*”, në kundërshtim me nenin 1, “Objekti dhe qëllimi” dhe neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006. Nga auditimi i DT të hedhura në faqen e APP.gov.al, rezultoi se janë hedhur në sistemin e APP.gov.al, specifikimet teknike të objektit: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” dhe jo specifikimet teknike të objektit të prokurimit, në kundërshtim me urdhrin e prokurimit. Në DT nuk është vënë kërkesa e VKM nr. 379, datë 11.06.2014, “Për disa shtesa në VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar”, në të cilin kërkohet që të paraqitet një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të energjisë që ka OE që është i regjistruar në Shqipëri.

Preventivat e paraqitura në DT kanë në zërat e strukturës, përveç fondit rezervë e tvsh, edhe taksën e lejes ndërtimit e të infrastrukturës, zërat e hartimit të projektit, mbikëqyerjen e punimeve të zbatimit dhe kolaudimin e punimeve, kundrejt totalit të çmimit. Nga auditimi rezultoi se Operatorët Ekonomik (OE) pjesëmarrës në tender nuk kanë ofertuar me strukturat e mësipërme.

**Zhvillimi i procedurës:** Procesverbalet e KVO kanë opinion kontradiktor për OE të kualifikuar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, në tërësi pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, **ato** nuk kanë asnjë informacion nëse janë llogaritur veprime aritmetikore si dhe për oferta anomalisht të ulëta.

**Rekomandim:** KLSH ti rekomandojë dhe kërkojë MAS, që në rastet eventuale të paraqitjes së nevojës objektive të ndryshimit të projektit dhe preventivit në momentin pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të punimeve (si në rastin e tenderit “**Mjedise sportive për 4 shkolla 9 vjeçare (Ndërtim palestre sportive), Bashkia Kukës**”, të veprojë në përputhje me KPA dhe të ndjekë zbatimin korrekt të procedurave ligjore për sigurimin e përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

**18. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Ndërtimi i shtesës së shkollës 9 vjeçare “Bajram Curri”, Kukës**”, me urdhër prokurimi nr. 43, datë 23.07.2014 dhe fond limit 138.742.757 lekë, rezultoi se llogaritja e fondit limit, i cili është kryer nga

subjekti “P...” shpk, i zgjedhur nga MAS, ka këto mangësi: Fondi limit i hedhur në tender është më shumë për 9.757.902 lekë, e përbërë nga mospërfshirja e punimeve për zërin ashensor, nga moszbatimi i VKM nr.568, datë 27.6.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, nga mospërfshirja e disa zërave në preventivin e hedhur në tender, etj.

Në llogaritjen e fondit limit, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.2007, mbi sigurinë në kantier, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit. MAS e ka dorëzuar projektin në Bashki pa kryer më parë oponencën teknike, pasi objekti është me vlerë mbi 100,000,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr.1055, datë 22.12.2010, “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, pikat 3 dhe 4.

Nga ana e Bashkisë Kukës, oponenca e këtij objekti, është përfunduar, nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit. mbas hapjes së procedurës së prokurimit dhe zhvillimit të saj në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6. Për kryerjen e oponencës nga ana Universitetit Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, është vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr. 7, datë 20.01.2014, të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, pika 1. Në oponencën e kryer janë rekomanduar disa ndryshime të projektit. Nuk na u vu në dispozicion asnjë dokumentacion se si është vepruar më tej me rekomandimet e oponencës teknike, nëse projekti është riparë nga projektuesi. Sa më sipër mban përgjegjësi MAS dhe AK që kanë kryer procedurat pa u reflektuar oponenca teknike e projektit.

Në zhvillimin e procedurës, në të cilin kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomikë, KVO, ka vlerësuar në vend të parë OE “K...” shpk & “E...”shpk, me vlerën më të ulët të ofruar prej 94,172,896 lekë, vlerë anomalisht e ulët, e cila është argumentuar nga ky i fundit me analizat e të gjitha çmimeve të ofertuara të preventivit dhe me një informacion argumentues. Nga OE i renditur i dyti, dhe mbas ankimimeve e rivlerësimit të KVO-së i treti në radhë “K...”shpk & “G...”shpk, me vlerë të ofertës 132,392,745 lekë, janë paraqitur ankimime në AK, të cilat nuk janë marrë në konsideratë e më tej në KPP, me objekt s`kualifikimin e OE me ofertë anomalisht të ulët, si dhe të OE “J...” shpk, i renditur i dyti në klasifikim, me vlerë të ofertës 115.123.112 lekë. KPP në vendimin e saj, përpara se të marrë në analizë materialin justifikues/argumentues të bashkimit të operatorëve ekonomikë “K...” sh.p.k. & “E...” sh.p.k., ka **vlerësuar t`i referohet edhe praktikës së legjislacionit të BE** mbi çështjen, (çështjen precedent *Lombardini and Mantovani* (C-285/99 [2001] ECR I-9233), Gjykata Europiane e Drejtësisë (Luksemburg), Direktivën përkatëse, (CES 515/2001), dokumenti “Parandalimi, Zbulimi dhe Përfundimi i Ofertave Anomalisht të Ulëta në Industrinë Europiane të Ndërtimit” *DG III 5 Qershor 1999*). etj dhe **ka** gjykuar se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “K...” sh.p.k & “E...” sh.p.k *nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të ishte skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe ka pranuar pretendimin e ankimuesit. Këtë pretendim e ka pranuar edhe për s`kualifikimin e OE të renditur të dytin në rradhë. Sipas KPP këtë tender*

**duhej ta fitonte OE me vlerë më të madhe prej 38,219.849 lekë nga ajo e shpallur fituese.**

AK ka lidhur kontratë nr.66, datë 06.10.2014 me OE fitues “K...” shpk, me vlerë të kontratës 113.007.745 lekë, me afat kohor 6 muaj nga lidhja e saj.

Nga ana e KPP për këtë procedurë është marrë vendim tjetër me objekt “Shfuqizim i vendimit të KVO-së, në lidhje me kualifikimin e BOE “K...”shpk & “E...”shpk, nr.578/1, datë 17.10.2014. Gjithashtu, nga auditimi i ankimimeve rezulton se BOE “G...” sh.p.k. & “K.....” sh.p.k., ka paraqitur ankimim në KPP, në të cilin rezulton se ky BOE disponon të dhëna të hollësishme për dokumentacionin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të OE “J...”shpk. Theksojmë se këto dokumente janë hedhur në sistemin e prokurimit elektronik, i cili përdoret për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin dixhital) të të dhënave, që transmetohen në rrugë elektronike, për kryerjen e procedurave të prokurimit. Ruajtja e të dhënave në këtë sistem kryhet në mënyrë që të sigurojnë **integritetin e tyre dhe konfidencialitetin e ofertave e të kërkesave për pjesëmarrje**. Për rrjedhojë KPP, gjatë shqyrtimit të ankesës duhej ta konstatoje këtë fakt (rrjedhjen e informacionit), bazuar në kërkesat e VKM nr. 659, datë 03.10.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike”, Kreu III, pika 13.

**Rekomandim:**

a.KLSH t`i rekomandojë MAS që në rastet e prokurimeve me objekt studim-projektim të objekteve shkollore, për llogari të NJQV-ve, të kryejë oponencën teknike dhe kërkojë ndaj Projektuesit zbatimin dhe reflektimin në projekt për objektet me vlerë mbi 100 milion lekë, si dhe të mos lejojë kryerjen e oponencës nga NJQV-të.

b. KLSH të regjistrojë indicien nga Departamenti auditues ose Departament tjetër për auditimin e paligjshmërisë së vendimit të KPP nr. 1618/1, datë 02.10.2014 ku është shprehur për skualifikimi i operatorit me ofertë anomalish të ulët lidhur me objektin “Ndërtimi i shtesës së shkollës 9 vjeçare “Bajram Curri”, Kukës”,

**19. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së varrezave publike”, Kukës”, me urdhër prokurimi nr. 01, datë 11.02.2014 dhe fond limit 1,660,400 lekë, rezultoi: për llogaritjen e fondit limit nuk ka urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për ngritjen e një grupi pune për hartimin e specifikimeve teknike, preventivit dhe llogaritjen e vlerës së kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu II, “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2, “Llogaritja e vlerës së kontratës”, nënpika “ç”. Në llogaritjen e shërbimit ruajtje objekti, nuk ka asnjë argumentim se si ka dalë vlera dhe sa roje duhen. Në DT në kapacitetin ligjor të operatorëve ekonomikë, veç të tjerash është kërkuar që të paraqiten vërtetim për fuqi punëtore të siguruar të paktën 3 punëtore, në një kohë që në përshkrimin e kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to, për ruajtje e objektit: është kërkuar ruajta dhe siguria e objektit në territorin e varrezave publike gjatë 24 orëve.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa, që të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik.

**20. Gjetje:** Në tenderat e zhvilluar me objekt: “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të qytetit Kukës, me urdhër prokurimi nr. 12, datë 05.06.2014 dhe fond limit 24.005.266 lekë, rezultoi se: nga ana e hartuesve të preventivit, nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 568, datë 27.6.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të

çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre. Në këto preventiva, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.2007, mbi sigurinë në kantier, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa për zbatimin e saktë të manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit dhe strukturave përbërëse të tij.

**21. Gjetje:** Në të gjitha kontratat e lidhura për blerje mallrash, në marrjen në dorëzim të mallrave, nuk ka gjetur zbatim Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, pasi nuk është ngritur grup për marrjen në dorëzim si dhe nuk ka akt/ certifikatë marrje në dorëzim, sipas pikës 42 .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa, që të ngrihet grupi i marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, të pasqyrojë dokumentacionin shoqëruar të tyre dhe të pasqyrojë e argumentojë me shkrim verifikimin faktik të tyre, sipas kërkesave ligjore.

**22. Gjetje:** Bashkia Kukës si Autoriteti Kontraktor dhe mbikëqyrësi i punimeve të ndërtimit, nuk kanë ushtruar kontrole periodike, për ndërtimin e objektit “*Rikonstruktion i shkollës së mesme “Havzi Nela”*”, me kontraktor operatorin ekonomik “*K... sh.p.k.*”, e për pasojë nuk është siguruar cilësia e punimeve të ndërtimit sipas kërkesave të standardeve, si dhe nga keqpërdorimi i ambienteve të shkollës, për periudhën që është brenda garancisë së punimeve, ka ndodhur dëmtim i objektit në vlerën **2,397,051 lekë**, veprim në kundërshtim me pikën 9, të Udhëzimit nr. 1, datë 22.02.2005 ”Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar .

**Rekomandimi:** Bashkia Kukës si Autoriteti Kontraktor të marrë masa për eliminimin e të gjithë defekteve që janë konstatuar në objektin “*Rikonstruktion i shkollës së mesme “Havzi Nela”*”, **me kontraktor** operatorin ekonomik “*K.... sh.p.k.*”

**23. Gjetje:** Struktura e tatime-Taksave funksionon në nivel sektori brenda Drejtorisë Ekonomike ku nga 9 punonjës është plotësuar me 6 faktik, pra struktura është pa plotësuar me 3 specialist ku mungojnë e nuk janë plotësuar vendet në pozicionet si: Agjent i tregut të bagëtive, agjent për vulat e mishit dhe agjent për parkingun e Bashkisë. Gjithashtu vetëm 3 rezultojnë me profesion ekonomi, ndërsa 4 specialist zotërojnë profesione të ndryshëm si: histori, sociologji, teknologji agro-ushqimore, profesione këto që nuk i përgjigjen kërkesave ligjore të vendit të punës gjendje kjo që ndikon në efektivitetin eficient dhe menaxhimin e punës së Sektorit të mbledhjes së të ardhurave vendore. Pra struktura përveç se nuk është e plotësuar me 3 punonjës, por ajo është e pa përshtatur me profesione për 4 specialist, gjendje kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” me ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28/07/2008 “Për Taksat Lokale” me ndryshime, dhe ndryshuar me ligjin nr. 181/2013”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" .

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e personelit dhe për të gjithë ato që do të merren në punë që të plotësojnë kriteret lidhur me profesionet e kualifikimin përkatës ligjor të strukturës së Tatime taksave dhe tarifave vendore.

**24. Gjetje:** Bashkia Kukës, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i të Ardhurave për vitet 2013 dhe 2014 në procesin e parashikim-programimit dhe gjatë procesit të ndjekjes dhe realizimit të mbledhjes së të ardhurave kanë lejuar shmangie të kundraligjshme nga parashikimi dhe grumbullimi i të ardhurave nga tatime-taksat dhe tarifrat me parashikime të pasakta e me rezerva planifikuar më të ulta përkatësisht 19,196 mijë lekë ose 25% më pak kundrejt planit parashikuar 75,000 mijë në vitin 2013 ndërsa 24584 mijë lekë ose 33% më pak kundrejt planit të parashikuar në vlerën 75,000 mijë lekë për vitin 2014, nga moszbatimi i normave te programimit dhe me performancë të ulët realizimi përkatësisht: *për vitin 2013*, nga 75,000 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 56,666 mijë lekë ose në masën në masën 76,0 %, më pak se parashikimi për vlerën 18,334 mijë lekë,ose nga 21 taksa e tarifa vendore paraqiten 19 me mos realizim dhe 2 me realizim. ndërsa *për vitin 2014*, nga 75,000 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 62,912 mijë lekë ose në masën në masën 83.8 %, më pak se parashikimi për vlerën 12,088 mijë lekë, ose nga 23 taksa e tarifa vendore paraqiten me mosrealizim 19 dhe 4 me realizim; pasqyruar hollësisht në tabelën “Pasqyra e realizimit te ardhurave për vitet 2013-2014 sipas rakordimeve me thesarin Kukës“, veprime që vijnë në kundërshtim me nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar” nenin 14, pika 4 ku shprehet:“Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, transferohet në buxhetin e bashkisë ose komunës, ku ka vendndodhje biznesi i taksueshëm”, ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Neni 74 “Për afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor“, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, dhe me udhëzimin nr. 656/1, datë 6.2.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të Taksave Vendore” pika 1 .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i të Ardhurave të marrë masa të hartojë e miratoje planin e të ardhurave dhe të zbatojë normat e programimit në parashikimin e saktë të planit të të ardhurave, duke përfshirë përveç të ardhurave nga tatime taksat sipas ligjit dhe të ardhurat nga vënia në eficencë e aseteve pasurive dhe resurseve ne pronësi përdorim e juridiksion të Bashkisë.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i të Ardhurave të marri masa dhe të evidentojë e hapë llogaritë e debitorëve, nga subjektet e tatime taksave të pa mbledhura përkatësisht në vlerën **18,334 mijë lekë**. *për vitin 2013*,dhe vlerën **12,088 mijë lekë**, për vitin 2014; (pasqyruar në tabelën “**Pasqyra e realizimit te ardhurave për vitet 2013-2014 sipas rakordimeve me thesarin Kukës**“), si dhe të kërkojë realizimin e arkëtimin në zbatim të procedurave ligjore përcaktuar ne ligjin për sistemin e tatime taksave dhe ligjin për procedurat tatimore.

**25.Gjetje:** Bashkia Kukës për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe prej vitit 2010 nuk ka një program vjetor të kryerjes së inventarizimeve dhe nuk është kryer inventarizimi fizik për identifikimin e gjendjes juridike fizike e teknike dhe vënies në eficencë të pronave-pasurive dhe aseteve pronë e bashkisë, të kërkuara dhe miratuara sipas 5 VKM-ve; VKM nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në Përdorim të Bashkisë Kukës të Qarkut të Kukësit”, VKM nr. 37, datë 18.01.2012, VKM nr. 618, datë 12.9.2012 “Për një Ndryshim në

Vendimin nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në Përdorim të Bashkisë Kukës, të Qarkut të Kukësit,” VKM nr. 115, datë 13.2.2013 “Për Disa Ndryshime në Vendimin nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në Përdorim të Bashkisë Kukës të Qarkut të Kukësit” dhe VKM nr. 815, 04.06.2008 .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të hartojë program vjetor të kryerjes së inventarizimeve dhe të kryejë inventarizimin fizik për identifikimin e gjendjes juridike fizike e teknike dhe vënies në efikasitet të pronave-pasurive dhe aseteve pronë e bashkisë, të kërkuara dhe miratuara sipas 5 VKM-ve dhe listave përkatëse.

**26. Gjetje:** Bashkia Kukës dhe strukturat përkatëse nuk kanë përgatitur një bilanc fillestar dhe aktual të përditësuar, pra ka munguar një bilanc i aseteve dhe pronave grupuar sipas funksioneve dhe gjendjes juridike, (dokument ky me funksion dhe që do të shërbente identifikimit të gjendjes tyre juridike, ruajtjes nga përdorimet e paligjshme, marrjes nën administrim dhe mirë menaxhimit e vënies në efikasitet e me efektivitet, sipas programeve përkatëse të EMP-ve, nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit, duke siguruar kështu të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e bashkisë dhe parashikuar shpenzimet me destinacion si dhe krijimin e burimeve të punësimit për komunitetin); pra të aseteve dhe pasurive të Bashkisë Kukës bazuar në kërkesat dhe listat e miratuara me VKB-të përkatës dhe sipas procedurës miratuar me 5 VKM –të e mësipërme ku listohen 1028 pasuri prej të cilave: 781 pasuri-prona me status juridik në pronësi, 3 prona-pasuri me status në përdorim dhe ka në juridiksion 244 prona-pasuri, pasqyruar në tabelën emërtuar “Bilanci Fillestar i pronave dhe aseteve transferuar në pronësi, përdorim dhe juridiksion të Bashkisë Kukës, sipas 5 VKM.-ve”, hartuar nga audituesit e KLSH gjatë procesit të auditimit bashkëlidhur këtij Raportit;

*- Në bilancin fillestar paraqitur më sipër nuk janë pasqyruar prej 3 vjetësh ndryshimet lidhur me kalimet e titujve të pronësisë, lidhur me dhëniet në përdorim ligjor me status përdorimi, apo lidhur me përdorimet e paligjshme nga persona të ndryshëm, pra ndryshime që lidhen me ruajtjen administrimin dhe menaxhimin e pasurive dhe aseteve si dhe ndryshime që lidhen me identifikimin inventarizimin, vlerësimin dhe përfshirjen në evidencën kontabile të vlerave ndërtimore, vlerës së trojeve, vlerës së tokës, vlerës së bimësisë, vlerës së fuqisë lëndore dhe kullosore për pyjet e kullotat .*

**Rekomandim:**

**a.** Bashkia Kukës dhe strukturat përkatëse, pasi të kryejë inventarizimin fizik sipas listave përfundimtare të pronave, bazuar në Bilancin fillestar hartuar nga KLSH pasqyruar në tabelën emërtuar “Bilanci Fillestar i pronave dhe aseteve transferuar në pronësi, përdorim dhe juridiksion të Bashkisë Kukës, sipas 5 VKM.-ve”, i cili pasqyron gjendjen fillestare prej vitit 2008-2010; të pjesshme fizike dhe në vlerë, të hartojë bilancin faktik të përditësuar të aseteve dhe pronave me 1028 pasurive nga të cilat: 781 pasuri-prona me status juridik në pronësi, 3 prona-pasuri me status në përdorim juridiksion 244 prona-pasuri grupuar sipas funksioneve dhe gjendjes juridike dhe të pasqyrojë ndryshimet lidhur me kalimet e titujve të pronësisë, me dhëniet në përdorim ligjor me status përdorimi.

**b.** Bashkia Kukës, strukturat përkatëse dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP), të marrin masa për vënien nën administrim dhe në efikasitet me efektivitet dhe të hartojnë programet përkatës të menaxhimit dhe planet e menaxhimit të aseteve resurseve e pronave sipas funksioneve (pasqyruar analitikisht sipas pikës 9.1 b), dhe të parashikojnë e përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat për secilin program duke i pasqyruar ato në Buxhetin e Bashkisë sipas periudhave dhe për çdo buxhet vjetor, që u përkasin: *781 pasuri në pronësi nga të cilat: 150 pasuri troje ndërtesa torturë sheshe me funksion administrativ arsimor kulturor sportiv historik social me sipërfaqe trualli 406 770 m<sup>2</sup>, nga e cila sipërfaqe ndërtimi 11343 m<sup>2</sup>, 147 pasuri me 356 830 ml rrugë vendore dhe 31000 ml rrjet kuz+kub; 23 pasurime sipërfaqe trualli 20100 m<sup>2</sup>, nga e cila sipërfaqe ndërtesa 9650 m<sup>2</sup>, 1 pasuri me 281 ha tokë PF dhe kanale të III-ta ;156 pasuri me sipërfaqe 1,125,142 m<sup>2</sup> të llojit gjelbërim e lulishte; 31 pasuri me sipërfaqe 12 726 m<sup>2</sup> të llojit sheshe ndërtimi; me funksion strehimi 239 pasuri apartamente me sipërfaqe banimi 17 968 m<sup>2</sup>, 9 pallate me sipërfaqe trualli 4150 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 3627 m<sup>2</sup>; me funksion mbrojtje civile 15 pasuri me sipërfaqe ndërtimi 336 m<sup>2</sup>, të llojit vendstrehime tunele etj; me funksion pyje mbrojtje e kullota 8 pasuri me sipërfaqe 151,5 ha nga e cila 7 pasuri me sipërfaqe 77,5 ha pyll, 1 pasuri me sipërfaqe 74 ha kullotë.*

**27.Gjetje:** Bashkia Kukës në strukturën organizative të Bashkisë për secilin prej 2 viteve 2013, 2014 dhe me parë nuk ka pasur specialist të arsimuar në drejtimin “Inxhinier për Mbarështimin e Pyjeve”, apo agronom; inxhinier ndërtimi megjithëse kjo Njësi Qeverisje Vendore administron rreth 151,5 ha pyje e kullota, 728 ha tokë bujqësore arë, pemëtores vresht, tokë PF e kanale të Treta ujitje-Kullimi, 112,5 ha sipërfaqe të gjelbëruara e lulishte urbane, përfshirë këtu sipërfaqe me bimësi pyjore, sipërfaqe flore dhe faunistike me flore bimësi e faunë të pasur për grumbullim bimësie, mbarështim e për përdorim gjuetie turistike e sportive etj dhe punësim.

Gjithashtu në këtë strukturë nuk përfshihet funksioni i Policisë Pyjore, duke mbetur zbuluar sigurimi i funksionit të mbrojtjes së pyjeve dhe tokës bujqësore pyjore nga dëmtimet, sipërfaqet e gjelberta, florës dhe faunës funksion i cili patjetër kërkon aftësitë e duhura për përcaktimin e llogaritjen e dëmeve eventuale dhe mbi bazën e tij zbatimin e ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar. Që buron nga ligji nr. 8743, datë 22.02.2001, i ndryshuar “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Kreun e II “Menaxhimi i Riskut”, Kreun III “Regjistri i Aktiveve”, Kreun IV “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, “Inventarizimi i Aktiveve” pikat 73,74 dhe 75 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, me 5 VKM nr. 167, datë 10.3.2010 VKM nr. 37, datë 18.01.2012, VKM nr. 618, datë 12.9.2012 VKM nr. 115, datë 13.2.2013” dhe VKM nr. 815, 04.06.2008 dhe në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe për këtë mbajnë përgjegjësi Kryetari i Bashkisë dhe Juristi dhe Drejtorët e Drejtorive përkatëse të cilët kanë hartuar e miratuar rregulloren me mangësi duke mos përfshirë saktësimin e përshkrimin e detyrimit dhe detyrave ligjore mbi strukturat përkatëse lidhur me marrjen nën administrim, identifikimin e gjendjes juridike menaxhimin e vënien në



eficencë aseteve, pronave e pasurive të paluajtshme, ushtrimin e kontrollit të territorit, hartimit e zbatimit të planeve e programeve të menaxhimit nga Ekipet përkatëse të menaxhimit (EMP) .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të Hartojë rregulloren e re të Funkcionimit ku të përcaktojë strukturat përkatëse për detyrimin e marrjes nën administrim ruajtje, duke hartuar dhe mbajtur dokumentet “Regjistri i Aktiveve”, “Sistemi i Kontrollit Periodik të Aktiveve”, “Inventarizimi i Aktiveve” detyrimin për menaxhimin e vënien në efencë e me efektivitet të aktiveve, aseteve, resurseve, pasurive etj, të rishkruajë dhe pasqyrojë nëpërmjet përshkrimit në vendet e punës “job discription” të detyrimeve ligjore për inventarizimin, Hartimin e programeve të menaxhimit dhe planeve të menaxhimit nga EMP, të llogaritjes dhe përfshirjes së shpenzimeve të dhe ardhurave sipas programeve dhe të pasqyrimin të tyre në Buxhetet Vjetore dhe Afatmesme; si dhe hartojë e përshtatë organikën e strukturës organizative me strukturat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore cituar më sipër, ku përshtatë krijimin e strukturave e të përfshijë specialist të arsimuar në drejtimet “Inxhinier për Mbarështimin e Pyjeve”, agronom; inxhinier ndërtimi etj, të cilët mungojnë, në përputhje me strukturën dhe llojshmërinë e aseteve me synim vënien nën efencë të tyre sipas funksioneve përcaktuar ne ligjet sipërcituar për administrimin e tokës. Planifikimin urban, administrimin e pyjeve, florës, faunës, territorit.

**28. Gjetje:** Listat përfundimtare të pronave që i bashkëlidhen 5 VKM-ve, të përgatitura dhe hartuara nga Bashkia Kukës bartin gabime pasaktësi e mangësi të rrjedhura nga gabimet e pasaktësitë e grupeve të përgatitjes së listave paraprake, nga mungesa e kryerjes së inventarizimeve periodike, e kontroleve periodike të të munguara, mangësi që lidhen kryesisht me asete të paidentifikuara me mos vlerësimin e sipërfaqeve në njësi fizike, dhe mos vlerësimin në vlerë e përfshirjen në kontabilitet etj, disa prej të cilave renditur më poshtë:

-referuar listës objektet nr 67 dhe nr. 138, janë dublim pasi shprehin objekt me emërtim të njëjtë” Kopshti Lagjes nr. 5 Kukës” dhe sipërfaqe të njëjta “trualli 2880 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 860 m<sup>2</sup>”,

-referuar listës objektet nr 100 dhe nr. 248-254 përkatësisht, nuk kanë të përcaktuar e vlerësuar e përfshirë ne kontabilitet vlerën ndërtimore të mureve apo rrethimi, ngrehinat, rrugët, shkallët, kanalizimet, pemët etj.

-referuar listës objektet nr. 257-402 “Rrjeti rrugë-vendore me 356 850 ml“ dhe nr. 255 “Rrjet kanalizime. KUB-KUZ me 31000 ml”, nuk kanë të matur e të saktësuar e përcaktuar sipërfaqja shprehur në m<sup>2</sup>, inventarët e aksesoret përbërës si muret mbajtës, urat, bankinat, pusetat, kolektorët dhe aksesore të tjerë përbërës, të cilat nuk janë vlerësuar në vlerë inventarizohen.

-referuar listës objektet nr. 66 “Kopshti i Lagjes nr. 3 me sipërfaqe trualli 390 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 390 m<sup>2</sup>“, nuk është matur e përfshirë sipërfaqja e oborrit dhe ambienteve funksional; nr. 68 “Shkolla Fillore Gostil, me sipërfaqe trualli 420 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 378 m<sup>2</sup>, nuk është matur e përfshirë sipërfaqja m<sup>2</sup> e oborrit dhe ambienteve funksional, gjelbërimi si dhe vlerësimi i murit rrethues e tjerë aksesorë; nr. 223 “Tokë pa frutë (PF) + sheshe + skarpate 52 913 m<sup>2</sup>+ kanale të treta ujite-kullimi me sipërfaqe totale 2 862 400 m<sup>2</sup>“, nuk janë matur verifikuar saktësuar e veçuar kanalet e treta ujitëse-kulluese në ml, m<sup>2</sup>, identifikuar sifonët dhe të vlerësohen e përfshihen me vlerën kontabile.

- Referuar listës nr. 115-126 “Trojet e kabinave të Kesh”, 12 pasuri, nr .131-210 ose 99 pasuri” Trojet e objekteve të ish ndërmarrjeve ekonomike në proces privatizimi të verifikohet marrëdhënia e truallit”, nr. 257-402 “ Rrjeti rrugëve vendore”, me 146 pasuri nuk është matur vlerësuar e saktësuar sipërfaqja në m<sup>2</sup>,vlerësohen e inventarizohen muret mbajtës, urat, bankinat.

Nuk janë vlerësuar vlera ndërtimore e nuk janë përfshirë në inventarin kontabël vlerat ndërtimore të objekteve si: për Rrugët vendore (vlera e trup rruge, asfalt, bankina, ura e tombina etj); për varrezat (vlera e objekteve ndërtesa, mure, rrethues e rrethime me kolona e tela, vlerat e pemëve dekorative, e bimësisë etj.), për vendstrehimet e tunelet (vlera e objektit ndërtimor konstruksioni betonarme, muri ndërtimor, portat, ajruetit etj), për fushat e sportit vlerat fillestare (përbërë nga portat, kanalizimet, rrethimi, etj) për stacionin e Pompimit për veprat ujore vlerat e kanaleve ujitëse se bashku me pikat e shpërndarjes etj. Vlerat e lulishteve dhe ambienteve të gjelbëruara vlerat e pemëve dekorative e bimësisë luleve etj., dhe aksesoret e tjerë .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të saktësojë e korrektojë gabimet dhe përcaktoje në to sipërfaqet funksionale të munguara dhe pa përfshira, që u përkasin objekteve sipas listave lidhur me: objektet nr 67 dhe nr. 138, të cilët janë dubluar, pasi shprehin objekt me emërtim të njëjtë”Kopshti Lagjes nr. 5 Kukës” dhe sipërfaqe të njëjta “trualli 2880 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 860 m<sup>2</sup>”; objektet nr 100 dhe nr. 248-254 përkatësisht nuk kanë të përcaktuar e vlerësuar e përfshirë ne kontabilitet vlerën ndërtimore të mureve apo rrethimi, ngrëhinat, rrugët, shkallët, kanalizimet, pemët etj; objektet nr. 257-402 “Rrjeti rrugë-vendore me 356 850 ml“ dhe nr. 255 “Rrjet kanaliz. KUB-KUZ me 31000 ml”, nuk kanë të matur e të saktësuar e përcaktuar sipërfaqja shprehur në m<sup>2</sup>, inventarët e aksesoret përbërës si muret mbajtës, urat, bankinat, pusetat, kolektorët dhe aksesore të tjerë përbërës, të cilat nuk janë vlerësuar në vlerë inventarizohen; objektet nr. 66 “Kopshti i Lagjes nr. 3 me sipërfaqe trualli 390 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 390 m<sup>2</sup>“, nuk është matur e përfshirë sipërfaqja e oborrit dhe ambienteve funksional; nr. 68 “Shkolla Fillore Gostil, me sipërfaqe trualli 420 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 378 m<sup>2</sup> “,nuk është matur e përfshirë sipërfaqja m<sup>2</sup> e oborrit dhe ambienteve funksional, gjelbërimi si dhe vlerësimi i murit rrethues e tjerë aksesorë; nr. 223 “Tokë pa frutë (PF)+sheshe + skrapate 52 913 m<sup>2</sup>+ kanale të treta ujite-kullimi me sipërfaqe totale 2 862 400 m<sup>2</sup>“, nuk janë matur verifikuar saktësuar e veçuar kanalet e treta ujitëse-kulluese në ml, m<sup>2</sup>, identifikuar sifonët dhe të vlerësohen e përfshihen me vlerën kontabile; si dhe objektet nr. 115-126 “Trojet e kabinave të Kesh”, 12 pasuri, nr .131-210 ose 99 pasuri” Trojet e objekteve të ish ndërmarrjeve ekonomike në proces privatizimi të verifikohet marrëdhënia e truallit”, nr. 257-402 “Rrjeti rrugëve vendore”, me 146 pasuri nuk është matur vlerësuar e saktësuar sipërfaqja në m<sup>2</sup>,vlerësohen e inventarizohen muret mbajtës, urat, bankinat.

Lidhur me vlerësimin e vlera ndërtimore dhe përfshirjen në inventarin kontabël të objekteve si *për Rrugët vendore* (vlera e trup rruge, asfalt, bankina, ura e tombina etj); *për varrezat* (vlera e objekteve ndërtesa, mure, rrethues e rrethime me kolona e tela, vlerat e pemëve dekorative, e bimësisë etj.), *për vendstrehimet e tunelet* (vlera e objektit ndërtimor konstruksioni betonarme, muri ndërtimor, portat, ajruetit etj), *për fushat e sportit* vlerat fillestare (përbërë nga portat, kanalizimet, rrethimi, etj) *për stacionin e Pompimit për veprat ujore* vlerat e kanaleve ujitëse se bashku me pikat e

shpërndarjes etj. Vlerat e lulishteve dhe ambienteve të gjelbëruara vlerat e pemëve dekorative e bimësisë luleve etj,

**29. Gjetje:** Bashkia Kukës, prej vitit 2008 sipas VKM nr. 815, datë 04.06.2008 “Për një shtesë në Listën e Inventarit dhe për miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave Pyje dhe Kullota që do të Transferohen në Pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore Bashkia Kukës, të Qarkut të Kukësit”, përfshirë në listën përfundimtare me nr. 247 bashkëlidhur VKM nr. 167, datë 10.3.2010, ka **në pronësi** pasuri dhe resurse pyjore prej 151,5 ha **me strukturën:** 77,5 ha pyje mbrojtës të llojit fletorë e halorë dhe 74 ha kullota të llojit dimëror e veror; ku nga auditimi konstatohet se :

1.- Sipas tabelës “Administrimi, Menaxhimi dhe Mbarështimi i Resurseve Pyjore” rezulton se:

Prej 7 vjetësh, nuk është hartuar e nuk është zbatuar asnjë plan menaxhimi e mbarështimi në kullota livadhe e në pyje, pra nuk është parashikuar, llogaritur e përfshirë në buxhetet përkatës asnjë shpenzim dhe e ardhur nga planet e menaxhimit të munguara, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve kullosore, drusore, produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve. Ky mosveprim vjen në kundërshtim me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, “Për Përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim dhe në kundërshtim me VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullosje dhe kositje”.

2. -Nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidencimin e përditësimin e sipërfaqes fizike, fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të kësaj bashkie. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenin 5 “Planet e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15, pika 2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

3. - Mungon e nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi bilancimit të fondit kullosor, mosveprim ky në kundërshtim ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor”, neni 5, pika 2 germa “b”, ”Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, ”Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullosor”, neni 14, “Planet e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore” .

#### **Rekomandim:**

**a.** Bashkia Kukës të hartojë dhe zbatojë planin e menaxhimit dhe mbarështimit në kullotave-livadheve dhe Planin e Menaxhimit të pyjeve,(të munguara) të parashikojë, llogaritë e përfshijë në buxhetet përkatës shpenzimet dhe të ardhurat sipas destinacionit që përcakton ligji lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese me synim zhvillimin e qëndrueshëm dhe vjeljen e produkteve kullosore, drusore, produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të destinuara si burime të ardhurash për zhvillim të qëndrueshëm, dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

**b.** Bashkia Kukës të marrë masa të kryejë inventarizim kadastral pyjor me synim evidencimin e përditësimit e sipërfaqes fizike, fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të kësaj bashkie, në përmbushje të nenit 5 “Planet e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15, pika 2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, dhe të Manualit të Mbarështimit të Pyjeve.

**c.** Bashkia Kukës të marrë masa të kryejë inventarizim kadastral në sipërfaqe dhe fuqi kullimore si dhe të bëjë mbajtjen, evidentimin, administrimin bilancimi e fondit kullor, së bashku me aksesorët si lerat e pirjes ujit bagëtive, pritrat e muret mbajtës etj, në përmbushje të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, neni 5, pika 2 germa “b”, ”Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, ”Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullor”, neni 14, “Planet e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”.

**30. Gjetje:** Bashkia Kukës nuk ka kryer inventarizimet fizike, nuk ka verifikuar e vënë në efencë dhe nuk ka identifikuar pronat e transferuara në pronësi sipas 5 VKM-ve, pasuri e asete të llojit troje objekte, që ka sjellë si pasojë përdorimin e jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie nga persona të ndryshëm prej 1, 5 vjetësh e më tepër, të 4 pallateve me sipërfaqe trualli 1624 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 1516 m<sup>2</sup> dhe të 5 pallate me sipërfaqe trualli 2476 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 2111 m<sup>2</sup>, të zëna forcërisht dhe për të cilat nga bashkia nuk është bërë inventarizimi i numrit të apartamenteve dhe identifikimi i personave që i përdorin në mënyrë të jashtëligjshme e pa tituj pronësie, pra dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për lirim e marrjen nën administrim të pronarit Bashkia Kukës si dhe nuk janë llogaritur kërkuar e arkëtuar të ardhurat nga përdorimi, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion arsimit, ndërtesa të ish-NB dhe ish ndërmarrjeve ekonomike”,

**30. Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa të inventarizojë numrin dhe sipërfaqet e apartamenteve që u përkasin 4 pallateve me sipërfaqe trualli 1624 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 1516 m<sup>2</sup> dhe 5 pallate me sipërfaqe trualli 2476 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 2111 m<sup>2</sup>, të zëna forcërisht, të bëjë identifikimin e personave përdorues të paligjshëm e pa tituj pronësie, të llogaritë e kërkojë ndaj personave përdorues të paligjshëm, arkëtimin e vlerës së dëmit ekonomik të shkaktuar nga përdorimi pa pagesë për periudhën 1,5 vjet duke ndjekur të gjitha hapat e duhur administrativ e ligjor e gjyqësor si dhe të marrë masat dhe ndjekë procedurat ligjore me organet ligj zbatuese të rendit për lirim dhe vënien nën administrim të pasurive të mësipërme, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion arsimit, ndërtesa të ish-NB dhe ish ndërmarrjeve ekonomike”.

**31. Gjetje:** Policia e Bashkisë Kukës, gjatë viteve 2013-2014 ka performancë të pamjaftueshme të punës shprehur me mungesën dhe kufizimin (vetëm tek tregtarët ambulant e transporti në qytet) e veprimtarisë në kontrollin tërësor të territorit në evidentimin e nxjerrjen e përgjegjësi, marrjen e masave ndaj subjekteve debitor për taksat, subjekteve mbi trajtimin e mjedisit e të infrastrukturës, mungesën e bashkëpunimit me strukturat e tjera si INUV, Njësia e Mjedisit, Urbanistikë, Drejtorinë e tatime Taksave etj, gjë që tregohet nga struktura e gjobave ndaj

subjekteve; dhe pamjaftueshmëri shprehur me nivelin e ulët të gjobave të vendosura më pak se 1/gjobë/muaj për punonjës policie, si dhe me mungesën e rakordimit me Financën me pasojë mungesën fizike të 5 blloqeve të fletë gjobave; derdhjet të vonuara të gjobave në bankë dhe mos derdhja, rrjedhur nga mungesa e vendosjes së mekanizmave të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin, rakordimin, kontrollin e blloqeve të Fletë Gjobave, inventarizimin derdhjen në kohë të vlerave monetare, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paraqitur në tabelat “Mbi administrimin inventarizimin e blloqeve të gjobave, nga Policia e Bashkisë Kukës“ .

#### **Rekomandim:**

**a.** Bashkia Kukës, Drejtoria Ekonomike dhe Policia Bashkiake të marrin masa e të kryejnë rakordimin e Blloqeve të fletë gjobave dhe të kërkojnë administrimin e 5 blloqeve të gjobave me nr. serial 000151-000183; 000184-000216; 000217-000232; 000233-000265 dhe 000332-000364, arkëtimin e vlerës së gjobave të prera dhe të vonuara e pa derdhura në Bankë që i përkasin vitit 2013-2014 sipas pasqyrës “*Mbi administrimin inventarizimin e blloqeve të gjobave, nga Policia e Bashkisë Kukës*“.

**b.** Bashkia Kukës dhe Policia bashkiake të hartojë planveprime mujore ku të përfshijë bashkëpunimin me strukturat e tjera si INUV, Njësia e Mjedisit, Urbanistikë, Drejtorinë e tatime Taksave etj, me synim vënien nën kontroll tërësor të territorit ruajtjen e Pronave dhe aseteve publike të Bashkisë e të veprimtarive për rritjen e shkallës së edukimit e ndërgjegjësimit të publikut në të mirë përdorimin e territorit ruajtjen e mjedisit, rendit social etj, si dhe rritjen e performancës së punës së Policisë.

**c.** Bashkia Kukës Drejtoria Ekonomike dhe Policia Bashkiake të marrin masa dhe të vendosin sistemin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, afatin e mbylljes së veprimeve dhe rakordimet përkatëse punonjës Policie me Sektorin e financës inventarizuesen e Letrave me vlerë, si dhe në Rregulloren e Brendshme të Seksionit të Policisë Bashkiake, Kreun e III “Dokumentacioni që mbahet në Seksionin e Policisë Bashkiake, neni 7, pika ku shprehet për “Regjistrin e Gjobave të vendosura nga efektivitë i Policisë Bashkiake”, të përfshihet e shprehet për mekanizmat dhe procedurat që duhen ndjekur, për kohën mënyrën dhe afatet e likuidimit dhe për mënyrën e rakordimit të blloqeve të gjobave të marra në dorëzim, blloqet dhe fletë gjobat e prera, të likuiduara dhe të ato mbetura në bllok apo të pa përdorura..

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore“, i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejnë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale si më poshtë:

**1. Gjetje:** Nga Bashkia janë likuiduar në favor të personit fizik “S...” për dy vitet, 2013 e 2014, vlera 2,400 mijë lekë. Likuidimet janë mbështetur në kontratën e lidhur, datë 20.04.2006, midis Bashkisë dhe personit fizik “S...”. Kontrata është lidhur me afat 25 vjet, me objekt: “Marrje nga bashkia në përdorim të sipërfaqes 4.000 m<sup>2</sup> x 25 lekë/ m<sup>2</sup> në vit. Në këtë truall është ndërtuar tregu, agro-ushqimorë.

Sipas aktit të themelimit, datë s’ka, viti 2008, administrimi i tregut, i është kaluar Shoqërisë Aksionere “T..... Agro - Ushqimorë i shitjes me pakicë dhe shumicë”, SH.A Kukës. Sipas akt themelimit datë s’ka, viti 2008, është themeluar, shoqëria “T.... Agro-Ushqimor i Shitjes me Shumicë dhe Pakicë”, ShA Kukës, me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës. Kapitali themeltar i shoqërisë ka vlerën 2.000.000 lekë, me 2.000 aksione, me vlerë nominale 1.000 lekë secili. Edhe statuti i SHA “T... Agro-ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, datë s’ka, është i miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si përfaqësues i pronës shtetërore, mbështetur në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Nga Bashkia është përballuar qiraja e truallit të tregut prej vitesh, pavarësisht se administrohet nga shoqëria “T.... agro-ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës (nga viti 2009), **në vlerën 7,200,000 lekë, që përbën dëm ekonomik.**

#### **Rekomandim:**

**a.** Të pasqyrohet në kontabilitet detyrimi në vlerën **7,200 mijë lekë**, që i përket “T..... agro-ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës, që rrjedh nga pagesa e qerasë së truallit nga bashkia.

**b.** Të merren masa dhe të ndiqen të gjithë procedurat ligjore, për arkëtimin e detyrimeve, në vlerën **7,200 mijë lekë** nga “T..... agro-ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës. Bashkia të ndjekë procedurat ligjore, për falimentimin e shoqërisë, nëse nuk u përgjigjet detyrimeve, që ka ndaj bashkisë.

**2. Gjetje:** Sipas Urdhër shpenzimi nr. 186, datë 11.12.2014, sa likuiduar në favor të “K...” sh.p.k, vlerën **3,244,260** lekë, sipas kontratës nr. 49, datë 21.08.2014, për blerje material ndërtimi, fatura nr. 144, datë 30.11.2014, sa likuiduar më shumë, krahasimisht me fletë hyrjen e magazinës në vlerën **3,787 lekë** (mosplotësim të kontratës).

**2.1 Rekomandim:** Të merren masa për arkëtimin e detyrimit nga “K...” Sh.p.k, për **3,787 lekë**, për sa është likuiduar më shumë.

**3. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt “**Blerje pjesë ndërrimi (goma, lubrifikant, etj)**”, me urdhër prokurimi nr. 20, datë 25.06.2014 dhe fond limit 3,499,900 lekë, rezultoi se në DT, janë vendosur kërkesa në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, pika “b”, “Kontratat e mallrave”.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “L..S”, i shpallur fitues, rezulton se nuk ka paraqitur numrin e punonjësve si dhe dokument që të vërtetojë se ka pikë servisi për automjete në qytetin e Kukësit, kërkesë e DT. Nisur nga sa më sipër ky tender duhej të anulohet nga ana e KVO, pasi OE pjesëmarrës në të nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit. Vlerësimi i KVO-së në këtë mënyrë ka shkaktuar pabarazi të OE, duke mos zbatuar kërkesat LPP, neni 1 dhe 2. Efekti ekonomik negativ i kësaj

procedure me pasojë dëm ekonomik është në shumën **282,750 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 62-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandim:** Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 282,750 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: L. D, A.C dhe F.T.

**4. Gjetje:** Në 4 tendera të zhvilluar me objekt: “Blerje ushqimesh”, me urdhër prokurimi nr.22, datë 22.04.2013, me fond limit 16,566,000 lekë, u konstatua se: fondi limit është llogaritur mbi nevojat e autoritetit kontraktor, duke shkaktuar një dëm ekonomik në shumën **548.260 lekë**, për të cilën mban përgjegjësi preventivuesi M.G .

**4.1 Rekomandim:** Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 548.260 lekë** nga preventivuesi Muhamet Gashi.

**5. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt: “**Blerje materiale për shërbime të ndryshme**”, me urdhër prokurimi nr.18, datë 24.06.2014 dhe fond limit 3,000,000 lekë, në zbatimin e kontratës së lidhur midis palëve rezultoi se: janë blerë artikuj mbi kontratën në shumën 346,210 lekë, janë blerë 17 artikuj që janë në kontratë, por që kanë çmime mbi kontratën e lidhur, në shumën 126,200 lekë, si dhe janë blerë mbi kontratën e lidhur 85 artikuj në shumën 1,037,790 lekë, në kundërshtim me kontratën e lidhur midis palëve nr.49, datë 21.08.2014, neni 1 dhe 3. Nga mosveprimet është shkaktuar efekt ekonomik negativ për mallrat e marra në sasi mbi kontratë në shumën 346,210 lekë dhe **dëm ekonomik** për mosrespektim të çmimeve të kontratës në shumën **126,200 lekë**.

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 126.200 lekë**, nga A.Z Përgjegjëse e Zyrës së Shpenzimeve, F. T Drejtor i Shërbimeve, magazinierja M.C dhe L. D, Drejtori Ekonomik.

**6. Gjetje:** Në tenderat e zhvilluar me objekt: “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të qytetit Kukës, me urdhër prokurimi nr.12, datë 05.06.2014 dhe fond limit 24,005,266 lekë, rezultoi se: OE “N...” shpk, i klasifikuar i pari në tender është terhequr nga gara dhe për të nuk është bërë konfiskimi i konfiskimi i sigurimit të ofertës **në shumën 500,659 lekë**.

Nga auditimi rezultoi se OE “Xh...” shpk me vlerë të ofertës 19,066,635 lekë, është s`kualifikuar nga tenderi, pasi vërtetimi i taksave vendore të vitit 2012, është mbi tre muaj nga data e hapjes së tenderit, në kundërshtim me kërkesat e dokumenteve të tenderit, për rrjedhojë ky OE, nuk duhej të s`kualifikohej, por duhej të shpallej fitues mbas tërheqjes nga gara të OE “N...” shpk. Mos shpallja e tij fitues **ka shkaktuar dëm ekonomik në shumën 800,477 lekë**, për të vilën mban përgjegjësi KVO

**Rekomandim:**

**a.**Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 500,659 lekë**, sigurim oferte, nga OE “N...” shpk.

**b. Rekomandim:** Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 800,477 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: L.D, A.C dhe F.T.

**7. Gjetje:** Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje konteniere mbetjesh urbane”**, me urdhër prokurimi nr.10, datë 27.03.2013 dhe fond limit 3.000.000 lekë, rezultoi se: është s’kualifikuar nga gara OE “B..”shpk, me vlerë më të ulët, i cili plotëson kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kualifikimit duke **shkaktuar dëm ekonomik prej 190,000 lekë**, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi KVO.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **për arkëtimin e shumës prej 190,000 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: L.D, A.C dhe F.T.

**8. Gjetje:** Bashkia Kukës si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **854,683 lekë** ndaj operatorit ekonomik “K.....” sh.p.k., në situacionimin e volumeve të punimeve për 4 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin **“Rikonstruksion i shkollës së mesme “Havzi Nela”**, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 104, datë 06.12.2013 .

**Rekomandimi:** Bashkia Kukës si Autoriteti Kontraktor, të ngrejë grup pune dhe të vlerësojë punimet e situacionuara dhe të rillogarisë detyrimin për arkëtimin në vlerën **854,683 lekë** nga operatori ekonomik “K.....” sh.p.k., për situacionimin e volumeve të punimeve për 4 zëra punimesh, në objektin **“Rikonstruksion i shkollës së mesme “Havzi Nela”**.

**9. Gjetje:** Bashkia Kukës si Autoriteti Kontraktor, ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **875,509 lekë** ndaj operatorit ekonomik **“O..çi” sh.p.k.**, në situacionimin e volumeve të punimeve për 15 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin **“Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të qytetit të Kukësit”**, në kundërshtim me kushtet e kontratës për punë publike nr. 47, datë 04.08.2014 .

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Kukës si Autoritet Kontraktor, të ngrejë grup pune dhe të vlerësojë punimet e situacionuara dhe të rillogarisë detyrimin për arkëtimin në vlerën **875,509 lekë** nga operatori **“O....” sh.p.k.** për situacionimin e volumeve të punimeve për 15 zëra punimesh në objektin **“Rikonstruksion i rrugëve të brendshme të qytetit të Kukësit”**.

## **Menjëherë**

**10. Gjetje:** Bashkia Kukës, *Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i të Ardhurave* në tejkallim të kompetencës ligjore ka kryer veprime e pranuar likuidime të detyrimeve të tatim taksave të **4 subjekteve** në vlerën **403,287 lekë** në kompensim të detyrimeve të Bashkisë për blerje mallrash materialesh lëndë djegëse, punimesh me situacion përkatësisht: Për subjektin Ismail Vata, për kompensim të detyrimit prej **23,832 lekë** për tatime taksa të ndërtese, tarife pastrimi e tabele të vitit 2014; për subjektin L. Company, për kompensim të detyrimit prej **262,600 lekë** për tatime taksa të ndërtese, tarife pastrimi e tabele të vitit 2012,2013, 2014; për subjektin D....1, për kompensim të detyrimit prej **116,875 lekë** për tatime taksa të ndërtese, tarife pastrimi e tabele të vitit 2013; për subjektin B...., , për kompensim të detyrimit prej **220,400 lekë** për tatime taksa të ndërtese, tarife pastrimi e tabele të vitit 2014. Këto veprime janë në kundërshtim me nr. 9632, datë 30.10.2006 **“Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar”**nenin 14, pika 4 ku shprehet: **“Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, transferohet në buxhetin e bashkisë ose komunës, ku ka vendndodhje biznesi i taksueshëm”**, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 **“Për Procedurat Tatimore në**



Republikën e Shqipërisë” Neni 74 “Për afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor“, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, që kanë sjellë si pasojë në tejkalim të kompetencës shkaktimin e dëmit ekonomik vlerën **403,287 lekë** .

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin **dëmit ekonomik në shumën prej 403,287 lekë** nga Kryetari dhe Drejtori Ekonomik, të cilët në tejkalim të kompetencës ligjore, kanë kryer veprime e pranuar likuidime të detyrimeve të tatim taksave të **4 subjekteve** në vlerën **403,287 lekë**, në kompensim të detyrimeve të Bashkisë për blerje mallrash materialesh lëndë djegëse, punimesh me situacion.

**11.Gjetje:** Bashkia Kukës, nuk ka kryer *inventarizimet* fizik nuk ka verifikuar e vënë në efikasitet dhe *nuk ka identifikuar pronat e transferuara në pronësi sipas 5 VKM-ve, pasuri e asete të llojit troje objekte, që ka sjellë si pasojë përdorimin e jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie nga persona të ndryshëm prej 1, 5 vjetësh e më tepër, përdorime për ndërtime apo ushtrime aktiviteteve të ndryshme si lavazhe etj, për banese etj, të sipërfaqes prej 21,420 m<sup>2</sup> truall në pronësi të Bashkisë me 1487 m<sup>2</sup> ndërtesa dhe 239 apartamenteve, që kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë dhe buxhetin e shtetit prej 50,716 mijë lekë (llogaritur me tarifën e VKM nr. 529, datë 8.6.2011”Për Përcaktimin e Kriterëve, Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira Emfiteozë apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 5.2.2014); si dhe përdorim të pa ligjshëm dhe pa titull pronësie të 4 pallateve me sipërfaqe trualli 1624 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 1516 m<sup>2</sup> dhe të 5 pallate me sipërfaqe trualli 2476 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 2111 m<sup>2</sup>, të zëna forcërisht dhe për të cilat nga bashkia nuk është bërë inventarizimi i numrit të apartamenteve dhe identifikimi i personave që i përdorin në mënyrë të jashtëligjshme e pa tituj pronësie, pra dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për lirimin e marrjen nën administrim të pronarit Bashkia Kukës si dhe nuk janë llogaritur kërkuar e arkëtuar të ardhurat nga përdorimi, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja, administrimi funksionimi dhe Efienca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion arsimit, ndërtesa të ish-NB dhe ish ndërmarrjeve ekonomike“, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04. 2004, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, dhe në kundërshtim me ligjin nr 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” .*

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat e duhur administrativ e ligjor, për të kërkuar arkëtimin dhe shlyerjen e vlerën **prej 50,716 mijë lekë** të ardhurave të munguara dhe dëmit ekonomik në ndaj personave shkaktar nga përdorimi i paligjshëm dhe pa tituj pronësie për periudhën prej 1,5 vjet të pronave të Bashkisë të llojit truall me sipërfaqe prej 21,420 m<sup>2</sup>, ndërtesa me sipërfaqe ndërtimi 1487 m<sup>2</sup> dhe 239 apartamenteve banimi, pasqyruar në tabelën emërtuar “Gjendja, administrimi funksionimi dhe Efienca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion arsimit, ndërtesa të ish-NB dhe ish ndërmarrjeve ekonomike“, si dhe të marrë masat dhe ndjekë procedurat ligjore me organet

ligjzbatuese të rendit për lirim dhe vënien nën administrim të pasurive të mësipërme.

**12. Gjetje:** Nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën korrik 2013-dhjetor 2014 të sipërfaqes prej **74 ha kullotë**, janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej **888,000 lekë**.

Gjithashtu nga auditimi i destinimit të të ardhurave të pa vjela nga përdorimi i Fondit kullor e pyjor rezultojnë se gjatë 1,5 viteve 2013-2014 nga të ardhurat e pa vjela nga përdorimi i kullota pyjeve në shumën prej 888,000 lekë është krijuar pamundësia për të veçuar, destinuar e përdorur 70% e vlerës prej 621,600 lekësh, shumë kjo që nuk është drejtuar e përdorur për përmirësimin e pyjeve kullotave dhe pyllit komunal, pra për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit për vënien në efikasitet të aseteve pyjorë dhe për mbarështimin e qëndrueshëm të tyre. Ky mosveprim vjen në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr. 396, datë 21.6.2006, ku shprehet se: “... *Jo më pak se 70% e fondit të krijuar sipas shkronjës “e” të pikës 5 të këtij vendimi përdoret për përmirësimin e pyllit Komunal*” dhe me pikën 3 shkronja “e” .

Për pasojë, nuk rezultojnë të jetë marrë asnjë e ardhur nga shfrytëzimi apo punimet kujdesuese të pyjeve mbrojtëse nga prerjet e kujdesimit silvikulturore, pra nuk është përdorur a shitur asnjë m<sup>3</sup>, prej 77.5 ha të mundshme për tu shfrytëzuar, duke respektuar kartën teknologjike silvikulturore dhe raportin prerje-rritje. Ky fakt tregon qartësisht mosvënien në efikasitet të aseteve pyje në pronësi e përdorim të kësaj Bashkie.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës të marrë masa duke ndjekur hapat e duhur ligjor dhe të kontabilizojë dhe kërkojë shlyerjen e të ardhurave të munguara dhe dëmin ekonomik në vlerën **888,000 lekë**, ndaj punonjësve shkaktar, rrjedhur nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën korrik 2013- dhjetor 2014 ,gjatë 1,5 vjet të sipërfaqes prej 74 ha kullotë, dhe lënia në kullote të lirë nga përdoruesit e paligjshëm; si dhe të respektojë destinacionin ligjor të përdorimit dhe të veçojë e krijojë fondet me destinacion e përdorim përkatësisht 70% e vlerës prej 621600 lekësh, për përmirësimin e pyjeve kullotave dhe pyllit komunal, pra për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit për vënien në efikasitet të aseteve pyjorë dhe për mbarështimin e qëndrueshëm të tyre, në zbatim të pikës 6 të VKM nr. 396, datë 21.6.2006.

**13. Gjetje:** Bashkia Kukës në 12 rastet e lëshimit të lejes së përdorimit, ku pronësia mbi truallin rezultojnë me kontratë kalimi pronësie nga Bashkia Kukës, përveçse tjetërsimi i tyre është kryer në mënyrë të kundraligjshme, nuk ka përllogaritur vlerën e qirasë së truallit të vënë në dispozicion, në referim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “*Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, për përcaktimin e tarifës dysheme për pasuritë shtetërore, vlera e qirasë mujore përllogaritet: “*Për truallin e lirë, tarifa dysheme e qirasë është 100 lekë/m<sup>2</sup> në muaj*”, mosveprim ky i cili ka sjellë pasojë financiare duke krijuar **të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,699,200 lekë (1191 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj)**.

Në 1 rast, është proceduar me dhënie e lejes me objekt “*Lokal shërbimi + banesë 2 kate + bodrum*” me investitor K.S dhe shoqëri zbatuese “O...” shpk, kur rezultojnë se objekti është ndërtuar mbi pasuri të llojit “Shesh”.

Në 1 rast, është proceduar me dhënien e lejes me objekt “Shtesë 1 kat Lokal shërbimi” me investitor Ramadan Prizreni dhe shoqëri zbatuese “Xh...” shpk, kur rezulton se objekti është ndërtuar mbi pasuri të llojit “Shesh-Lulishte”.

Në 1 rast, është proceduar me dhënien e lejes së përdorimit me objekt “Kompleks banimi dhe shërbim 7+2 kate”, me leje ndërtimi nr. 119, datë 29.09.2011, nr. 142, datë 29.09.2011 dhe nr. 03/1, datë 12.03.2014, me subjekt ndërtues “A..” sh.p.k., dhe pronar trualli A.Z, kur rezulton se objekti është në shkelje të lejes pasi është ndërtuar mbi pasuri të llojit “Shesh” .

**Rekomandim:**

a. Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën prej 1,699,200 lekë, sipas tabelës përkatëse bashkëlidhur. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet me kontratë shitje trualli nga bashkia duke u përllogaritur detyrimi i qirasë që nga periudha kur ka lindur marrëdhënia me truallin (dhënia e lejes së përdorimit) deri në hartimin e kontratës së kalimit të pronësisë.

b. Bashkia Kukës ti kërkojë Regjistruesit të ZVRPP Kukës, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë, deri në rregullimin e duhur ligjor të pronësisë mbi truallin dhe të së drejtës të njërive vendor të shitjes së trojeve, si dhe shlyerjes së detyrimeve të krijuara nga mos përllogaritja e vlerës së qirasë, duke njoftuar KLSH mbi zbatimin e këtyre kufizimeve

**14. Gjetje:** Bashkia Kukës në hartimin dhe nënshkrimin e 10 kontratave të truallit përveçse ka bërë tjetërsimin e tyre në mënyrë të kundraligjshme nuk ka përllogaritur vlerën e qirasë së truallit të vënë në dispozicion, në referim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, për përcaktimin e tarifës dysheme për pasuritë shtetërore, vlera e qirasë mujore përllogaritet: “Për truallin e lirë, tarifa dysheme e qirasë është 100 lekë/m<sup>2</sup> në muaj”, mosveprim ky i cili ka sjellë pasoja financiare duke krijuar të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 5,805,000 lekë (3225 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj) .

**Rekomandim:**

a. Bashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën prej 5,805,000 lekë, sipas tabelës përkatëse në raportin e auditimit. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet me kontratë shitje trualli nga bashkia duke u përllogaritur detyrimi i qirasë që nga periudha kur ka lindur marrëdhënia me truallin (dhënia e lejes së përdorimit) deri në hartimin e kontratës së kalimit të pronësisë.

b. Bashkia Kukës ti kërkojë Regjistruesit të ZVRPP Kukës, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë, deri në rregullimin e duhur ligjor të pronësisë mbi truallin dhe të së drejtës të njërive vendor të shitjes së trojeve, si dhe shlyerjes së detyrimeve të krijuara nga mos përllogaritja e vlerës së qirasë, duke njoftuar KLSH mbi zbatimin e këtyre kufizimeve.

**15. Gjetje:** Bashkia Kukës në 11 raste, ka kryer transaksione të kalimit të pronësisë të apartamenteve, pa pagesë në kundërshtim me VKM nr. 97, datë 03.2.2008 “Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 dhe

ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004”, procedura nga ku *vetëm nga mos aplikimi i tarifës sipas kontratave respektive bashkisë i është krijuar një dëm ekonomik i cili minimalisht është në vlerën prej 744,448 lekë (sipas përlllogaritjes në kontratat respektive të bëra në vitin 1993.*

**Rekomandim:** a. ashkia Kukës të kërkojë në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën **prej 744,448 lekë**, sipas tabelës përkatëse të Raportit të auditimit. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha apartamentet duke u përlllogaritu detyrimi i saktë i vlerës që nga periudha kur ka lindur marrëdhënia me objektin, deri në hartimin e kontratës së kalimit të pronësisë pa pagesë të tij.

b. Bashkia Kukës ti kërkoj Regjistruesit të ZVRPP Kukës, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, të nxjerrë urdhër kufizimi mbi pasuritë, deri në saktësimin dhe shlyerjen e detyrimeve të krijuara nga mos përlllogaritja e vlerës së objektit dhe truallit, duke njoftuar KLSH mbi zbatimin e këtyre kufizimeve.

**16. Gjetje:** Nga rakordimet e kryera dhe të munguara më parë gjendja e gjobave të prera për vitet periudhë auditimi para viteve 2013, në vitin 2013 dhe 2014 rezultojnë përkatësisht **60 gjoba me 70,500 lekë** të prera dhe të pa mbledhura apo derdhur, arkëtuar që përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Detyrimet e Punonjësve të Policisë Bashkiake për Gjobat e vendosura dhe të pa vjelura e pa derdhura Bashkia Kukës**” mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

**Rekomandim:** Bashkia Kukës, Drejtoria Ekonomike dhe Policia Bashkiake, të marrin masa duke kontabilizuar e ndjekur të gjitha hapat ligjorë për të kërkuar anketimin e vlerës së **60 gjoba me 70,500 lekë** të prera dhe të pa mbledhura, apo pa arkëtuar që përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Detyrimet e Punonjësve të Policisë Bashkiake për Gjobat e vendosura dhe të paarkëtuara nga Bashkia Kukës**”.

## C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, **kërkojmë** Kryetarit të Bashkisë Kukës, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

**1. Për z. B.B,** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe me cilësinë kryetar i njësisë së hartimit të Dokumenteve të tenderit, pasi në tenderat e zhvilluar me objekt: - “Blerje ushqimesh, 4 lote”, me fond limit 16,566,000 lekë, në DT nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportimin e mishit dhe bulmetit, nuk është

përcaktuar se çfarë lloj mjetesh duhet të paraqitet nga OE, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, për 14 artikuj ushqimorë nuk janë dhënë specifikimet teknike që duhet të plotësohen, në specifikimet teknike, janë përcaktuar për disa artikuj referencat e markave, në 16 artikuj në asnjë rast nuk janë përcaktuar standardet dhe cilësia, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

- “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me fond limit 1,209,500 lekë, “Blerje materiale për koktejet e fundvitit 2014”, me fond limit 600,000 lekë, “Blerje materiale për dekorin e Vitit të Ri 2014”, me fond limit 1,078,000 lekë, “Dekori i Vitit të Ri 2015”, me fond limit 1,543,400 lekë, procedura e përzgjedhur e prokurimit “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenin 33., Për kontratën shtesë në masën 20%, në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me arsyetimin për shkak të lindjes së nevojës për këto shërbime shtesë, në shumën 233.140 lekë, nuk ka asnjë argumentim për shtesën, nuk ka urdhër prokurimi artikujt që janë kontraktuar shtesë.

- “Blerje konteniere mbetjesh urbane” me fond limit 3,000,000 lekë, “Blerje materiale kancelarie për nevoja të bashkisë”, me fond limit 3,254,647 lekë, “Blerje pjesë ndërrimi (goma, lubrifikant, etj), me fond limit 3.499.900 lekë, në DT, në kriteret e veçanta për kualifikim, është kërkuar që të paraqiten vërtetim për fuqi punëtore të siguar, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, pika “b”, “Kontratat e mallrave”.

- “Blerje dru zjarri për vitin akademik 2013 -2014 për institucionet në varësi të bashkisë Kukës” me fond limit 3,300,000 lekë, nga ana e AK është lidhur kontratë shtesë nr.69/1, datë 15.2.2014, në shumën 640,000 lekë, për të cilën nuk ka asnjë e dhënë se ku kanë lindur nevojat, nuk ka urdhër prokurimi nga ana e titullarit të AK për kryerjen e procedurave të prokurimit për shtesën në masën 20% të vlerës së kontratës, në kundërshtim me po këtë VKM, Kreu IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, pika “c”.

- “Mjedise sportive për 4 shkolla 9 vjeçare (Ndërtim palestre sportive)”, me fond limit 25,828,331 lekë, është vendosur kërkesa se prioritet kanë operatorët ekonomikë që kanë mjetet në pronësi, në kundërshtim me nenin 1, “Objekti dhe qëllimi” dhe neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në sistemin e APP.gov.al, janë hedhur specifikimet teknike të objektit: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” dhe jo specifikimet teknike të objektit të prokurimit, në kundërshtim me urdhrin e prokurimit, në DT nuk është vënë kërkesa e VKM nr. 379, datë 11.06.2014, për të paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në preventivat e paraqitura në DT, në zërat e strukturës, përveç fondit rezervë e tvsh, janë edhe: taksa e lejes së ndërtimit e të infrastrukturës, zërat e hartimit të projektit, mbikëqyrja e punimeve të zbatimit dhe kolaudimin e punimeve, kundrejt totalit të çmimit.

- “Supervizioni i punimeve të ndërtimit të shtesës së shkollës 9 vjeçare “Bajram Curri”, me fond limit 1,068,800 lekë dhe “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të

qytetit Kukës”, me fond limit 24,005,266 lekë, kontrata është lidhur vetëm me një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 3.

- “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të qytetit Kukës”, me fond limit 24,005,266 lekë operatori ekonomik “Nika” shpk është tërhequr nga tenderi dhe nga ana e AK, nuk është vepruar ndaj kompanisë së sigurimeve “E....”, për konfiskimin e sigurimit të ofertës në shumën 500,659 lekë.

- “Ndërtimi i shtesës së shkollës 9 vjeçare “Bajram Curri”, Kukës”, me fond limit 138,742,757 lekë, preventivat e paraqitura nga MAS janë pranuar me mangësi nga ku rezulton se fondi limit i hedhur në tender është më shumë për 9,757,902 lekë, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05 2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, mbi sigurinë në kantier, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit.

- Për veprimet dhe mosveprimet lidhur me vonesat dhe me nivelin e pamjaftueshëm në moszbatimin e disa rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 523/10 Prot, datë 10.10.2013 dhe rikërkuar me shkresën nr. 1016/27, datë 30.6.2014, në kundërshtim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, trajtuar ne faqet 12-13 te Raportit Përfundimtar.

- Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me masat e marra për implementimin e MFK dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2014, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me mos funksionimin e strukturave, në kundërshtim me nenet 19,20, 21,dhe 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“ dhe nenin 66 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, trajtuar ne faqet 31 te Raportit Përfundimtar. Për hartimin për nënshkrimin dhe zbatim e urdhrave nr. 47,datë 24.2.2014 dhe nr. 150, datë 9.10.2014 me tejkallim kompetencash dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Neni 74 “Për afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor“,ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik që kanë sjellë si pasojë në tejkallim të kompetencës ligjore janë pranuar likuidime të detyrimeve të tatim taksave të 4 subjekteve në vlerën **403,287 lekë** në kompensim të detyrimeve të Bashkisë për blerje mallrash materialesh lëndë djegëse, punimesh me situacion, veprime i cili përbën dëm ekonomik.

- Për veprimet dhe mosveprimet si moskryerja e inventarizimit fizik dhe teknik, mos verifikimi e mosvënia në efikasitet e pasurive mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04. 2004, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”,në kundërshtim

me VKM nr. 529, datë 8.6.2011”Për Përcaktimin e Kritereve, Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira Emfiteozë apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore” ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullosje dhe kositje” dhe në kundërshtim me ligjin nr 8652, datë 31.7.2000 ”Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, që ka sjellë pasojë të ardhura të munguara dhe dëmin ekonomik dhe në mos ushtrim të kompetencave nuk janë kryer inventarizimet, pra nuk janë identifikuar objekte, troje e asete të tjera, që ka sjellë si pasojë përdorimi e paligjshëm me ndërtime apo me ushtrime aktivitetesh të ndryshme si lavazhe etj, dhe përdorim për banese përdorim të jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie nga persona të ndryshëm të sipërfaqes prej 21420 m<sup>2</sup> truall në pronësi të Bashkisë me 1487 m<sup>2</sup> ndërtesa dhe 239 apartamenteve, që kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë dhe buxhetin e shtetit prej **50,716 mijë lekë** për shfrytëzim dhe përdorim të jashtë ligjshëm dhe pa titull pronësie; si dhe Nuk janë bërë llogaritjet për të ardhurat e munguara dhe dëmin ekonomik për 4 pallate të zaptuara me sipërfaqe trualli 1624 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 1516 m<sup>2</sup> të zëna forcërisht dhe për 5 pallate me sipërfaqe trualli 2476 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 2111 m<sup>2</sup>, për shkak të mungesës së identifikimit të inventarizimit të personave nga bashkia që i përdorin jashtë ligjit, shtuar dhe nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën korrik 2013-dhjetor 2014 të sipërfaqes prej 74 ha kullotë, janë krijuar të ardhura të munguara dhe dëmi ekonomik na vlerën prej **888,000 lekë**, llogaritur, për të cilën bashkia ti llogarisë e arkëtojë këto të ardhura.

- Për shoqërinë “T.... agro-ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës, vazhdon të ketë detyrime të bartura, ndaj Bashkisë, nga taksat dhe tarifatat vendore 17,280,000 lekë. Gjithashtu, nga Bashkia është përballuar qiraja e truallit të tregut prej vitesh, pavarësisht se administrohet nga shoqëria “T... agro-ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës (nga viti 2009), **në vlerën 7,200,000 lekë**. Nga Bashkia Kukës, me “T... agro ushqimor i shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës, nuk është lidhur asnjë kontratë apo marrëveshje, për administrimin e tregut. Përfundimisht ndaj “T... agro ushqimor të shitjes me pakicë dhe shumicë”, Sh.A. Kukës, Bashkia Kukës është kreditore në shumën **24,480,000 lekë e cila përbëhet nga shlyerje qira trualli në vlerën 7,200,000 lekë**, të shlyera nga Bashkia (duhej të shlyhej nga shoqëria) dhe detyrime të pa shlyera nga shoqëria në favor të Bashkisë, për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **17,280,000 lekë**. Veprimet dhe mos veprimet e Bashkisë Kukës, kryesisht kanë ardhur si rezultat i paqartësive, pasi rast pas rasti i janë drejtuar për zgjidhje Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (si pronarë), kur duhej të bashkëvepronin me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Kukës (kontrollon bilancet e shoqërisë).

Nga Bashkia Kukës, nuk është zbatuar neni 14, “Kërkesë për hapjen e procedurës falimentimit” dhe neni 17, “Kërkesë e kreditorit”, të ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar. Gjithashtu nuk është zbatuar neni 5, i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010.

- Për veprime në kundërshtim me ligjin Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013,

VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit” e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe ligjin nr. 8420, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,699,200 lekë (1191 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj).

- Pasi në referim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, për përcaktimin e tarifës dysHEME për pasuritë shtetërore, vlera e qirasë mujore përllogaritet: “Për truallin e lirë, tarifa dysHEME e qirasë është 100 lekë/m<sup>2</sup> në muaj”, mosveprim ky i cili ka sjellë pasoja financiare duke krijuar të ardhura të munguara për Bashkinë Kukës në vlerën prej 5,805,000 lekë (3225 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj), trajtuar faqe 163 të Raportit Përfundimtar,

**2. Për z. N.C,** në cilësinë e anëtarit të NJHDT, pasi në tenderat e zhvilluar me objekt:

**1-** “Blerje ushqimesh, 4 lote”, me fond limit 16,566,000 lekë, në DT nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportimin e mishit dhe bulmetit, nuk është përcaktuar se çfarë lloj mjetesh duhet të paraqitet nga OE, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, për 14 artikuj ushqimorë nuk janë dhënë specifikimet teknike që duhet të plotësohen, në specifikimet teknike, janë përcaktuar për disa artikuj referencat e markave, në 16 artikuj në asnjë rast nuk janë përcaktuar standardet dhe cilësia, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

**2-** “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me fond limit 1,209,500 lekë, “Blerje materiale për koktejet e fundvitit 2014”, me fond limit 600,000 lekë, “Blerje materiale për dekorin e Vitit të Ri 2014”, me fond limit 1,078,000 lekë, “Dekori i Vitit të Ri 2015” me fond limit 1,543,400 lekë, procedura e përzgjedhur e prokurimit “me negociim pa shpallje paraprake të botimit”, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, neni 33, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”. Për kontratën shtesë në masën 20%, në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me arsyetimin për shkak të lindjes së nevojës për këto shërbime shtesë, në shumën 233,140 lekë, nuk ka asnjë argumentim për shtesën, nuk ka urdhër prokurimi artikujt që janë kontraktuar shtesë.

**3-** “Blerje konteniere mbetjesh urbane” me fond limit 3,000,000 lekë, “Blerje materiale kancelarie për nevoja të bashkisë” me fond limit 3,254,647 lekë, “Blerje pjesë ndërrimi (goma, lubrifikant, etj), me fond limit 3,499,900 lekë, në DT, në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar që të paraqiten vërtetim për fuqi punëtore të siguruar, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, pika “b”, “Kontratat e mallrave”.

**4-** “Blerje dru zjarri për vitin akademik 2013-2014 për institucionet në varësi të bashkisë Kukës” me fond limit 3,300,000 lekë, nga ana e AK është lidhur kontratë



shtesë nr.69/1, datë 15.2.2014, në shumën 640,000 lekë, për të cilën nuk ka asnjë e dhënë se ku kanë lindur nevojat, nuk ka urdhër prokurimi nga ana e titullarit të AK për kryerjen e procedurave të prokurimit për shtesën në masën 20% të vlerës së kontratës, në kundërshtim me po këtë VKM, Kreu IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, “Procedura me negociimi, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, pika “c”.

5- “Mjedise sportive për 4 shkolla 9 vjeçare (Ndërtim palestre sportive)”, me fond limit 25,828,331 lekë, është vendosur kërkesa se prioritet kanë operatorët ekonomikë që kanë mjetet në procesi, në kundërshtim me nenin 1, “Objekti dhe qëllimi” dhe neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në sistemin e APP.gov.al, janë hedhur specifikimet teknike të objektit: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” dhe jo specifikimet teknike të objektit të prokurimit, në kundërshtim me urdhrin e prokurimit, në DT nuk është vënë kërkesa e VKM nr. 379, datë 11.06.2014, për të paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në preventivat e paraqitura në DT, në zërat e strukturës, përveç fondit rezervë e tvsh, janë edhe: taksa e lejes së ndërtimit e të infrastrukturës, zërat e hartimit të projektit, mbikëqyrja e punimeve të zbatimit dhe kolaudimin e punimeve, kundrejt totalit të çmimit.

6- “Ndërtimi i shtesës së shkollës 9 vjeçare “Bajram Curri”, Kukës”, me fond limit 138.742.757 lekë, preventivat e paraqitura nga MAS janë pranuar me mangësi nga ku rezulton se fondit limit i hedhur në tender është më shumë për 9,757,902 lekë, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05 2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, mbi sigurinë në kantier, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit.

3. **Për z. M.G**, në cilësinë e anëtarit të NJHDT dhe të zyrtarit që ka llogaritur fondin limit, pasi në tenderat e zhvilluar me objekt:

1- “Blerje ushqimesh, 4 lote”, me fond limit 16,566,000 lekë, në DT nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportimin e mishit dhe bulmetit, nuk është përcaktuar se çfarë lloj mjetesh duhet të paraqitet nga OE, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, për 14 artikuj ushqimorë nuk janë dhënë specifikimet teknike që duhet të plotësohen, në specifikimet teknike, janë përcaktuar për disa artikuj referencat e markave, në 16 artikuj në asnjë rast nuk janë përcaktuar standardet dhe cilësia, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

Nga auditimi i llogaritjes së fondit limit, rezulton se përlllogaritja e numrit të frekuentuesve, për konsum ushqimor, është kryer bazuar vetëm në të dhënat e dy muajve të njëpasnjëshëm (mars, prill 2013), edhe ky jo i sakte, duke mos marrë në konsideratë periudhën e plotë për llogaritjen e numrit mesatar. duke llogaritur fondin limit mbi nevojat, **me pasojë dëm ekonomik në shumën 548,260 lekë.**

2- “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me fond limit 1,209,500 lekë, “Blerje materiale për koktejet e fundvitit 2014”, me fond limit 600,000 lekë, “Blerje materiale për dekorin e Vitit të Ri 2014”, me fond limit 1,078,000 lekë, “Dekori i

Vitit të Ri 2015” me fond limit 1,543,400 lekë, procedura e përzgjedhur e prokurimit “me negociim pa shpallje paraprake të botimit”, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenin 33, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”. Për kontratën shtesë në masën 20%, në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje materiale elektrike për nevojat e Bashkisë”, me arsyetimin për shkak të lindjes së nevojës për këto shërbime shtesë, në shumën 233,140 lekë, nuk ka asnjë argumentim për shtesën, nuk ka urdhër prokurimi artikujt që janë kontraktuar shtesë.

3- “Blerje konteniere mbetjesh urbane” me fond limit 3,000,000 lekë, “Blerje materiale kancelarie për nevoja të bashkisë” me fond limit 3,254,647 lekë, “Blerje pjesë ndërrimi (goma, lubrifikant, etj), me fond limit 3,499,900 lekë, në DT, në kriteret e veçanta për kualifikim është kërkuar që të paraqiten vërtetim për fuqi punëtore të siguruar, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, pika “b”, “Kontratat e mallrave”.

4- “Blerje dru zjarri për vitin akademik 2013 -2014 për institucionet në varësi të bashkisë Kukës” me fond limit 3,300,000 lekë, nga ana e AK është lidhur kontratë shtesë nr.69/1, datë 15.2.2014, në shumën 640,000 lekë, për të cilën nuk ka asnjë e dhënë se ku kanë lindur nevojat, nuk ka urdhër prokurimi nga ana e titullarit të AK për kryerjen e procedurave të prokurimit për shtesën në masën 20% të vlerës së kontratës, në kundërshtim me po këtë VKM, Kreu IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5, “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, pika “c”.

5- “Mjedise sportive për 4 shkolla 9 vjeçare (Ndërtim palestre sportive)”, me fond limit 25,828,331 lekë, është vendosur kërkesa se prioritet kanë operatorët ekonomikë që kanë mjetet në pronësi, në kundërshtim me nenin 1, “Objekti dhe qëllimi” dhe neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në sistemin e APP.gov.al, janë hedhur specifikimet teknike të objektit: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme” dhe jo specifikimet teknike të objektit të prokurimit, në kundërshtim me urdhrin e prokurimit, në DT nuk është vënë kërkesa e VKM nr. 379, datë 11.06.2014, për të paraqitur një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në preventivat e paraqitura në DT, në zërat e strukturës, përveç fondit rezervë e tvsh, janë edhe: taksa e lejes së ndërtimit e të infrastrukturës, zërat e hartimit të projektit, mbikëqyrja e punimeve të zbatimit dhe kolaudimin e punimeve, kundrejt totalit të çmimit.

-Për veprime në kundërshtim me ligjin Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit” e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe ligjin nr. 8420, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,699,200 lekë (1191 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj).

- Nga ana IMTV nuk janë ushtruar kontrole apo nuk dokumentohet që në zbatim ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” dhe konkretisht të nenit 5, të ketë kryer: Kontrole në drejtim të plotësisimit të Dosjes të objektit me dokumentacionin e nevojshëm, teknik dhe ligjor; Kontrole për zbatimin e kushteve teknike në ndërtim; si dhe Kontrole në terren, për zbatimin e Lejeve të përdorimit të dhëna për vitet 2013-2014. Nuk janë ushtruar kontrole për zbatimin e ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, me ndryshime.

**4. Për z. R.M,** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit, dhe me detyrë Drejtor i Planifikimit Urban

Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Ndërtimi i shtesës së shkollës 9 vjeçare “Bajram Curri”, Kukës”, me fond limit 138,742,757 lekë, preventivat e paraqitura nga MAS janë pranuar me mangësi nga ku rezulton se fondit limit i hedhur në tender është më shumë për 9,757,902 lekë, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimi i VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, mbi sigurinë në kantier, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit.

Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Mjedise sportive për 4 shkolla 9 vjeçare (Ndërtim palestre sportive)”, me fond limit 25,828,331 lekë, Me ndërhyrjen e MAS për rishikimin e projektit ka vepruar pa asnjë dokumentacion nga MAS, duke bërë ndryshim destinacioni, dhe duke anashkaluar procedurat e prokurimit, pasi në tender është hedhur tjetër objekt. Nuk ka asnjë kontratë midis palëve për ndryshimin e volumeve të punës.

- Për veprimet dhe mosveprimet lidhur me vonesat dhe me nivelin e pamjaftueshëm në moszbatimin e disa rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 523/10 Prot, datë 10.10.2013 dhe rikërkuar me shkresën nr. 1016/27, datë 30.6.2014, në kundërshtim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, trajtuar ne faqet 12-13 te Raportit Përfundimtar.

- Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me masat e marra për implementimin e MFK dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2014, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me mos funksionimin e strukturave, në kundërshtim me nenet 19,20, 21,dhe 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“ dhe nenin 66 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, trajtuar ne faqet 31 te Raportit Përfundimtar,

Për veprimet dhe mosveprimet si më sipër, si moskryerja e inventarizimit fizik dhe teknik, mos verifikimi e mosvënia në efikasitet e pasurive mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04. 2004, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 8.6.2011”Për Përcaktimin e Kritereve,

Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira Emfiteozë apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore” ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullosje dhe kositje” dhe në kundërshtim me ligjin nr 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, që ka sjellë pasojë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik dhe në mos ushtrim të kompetencave nuk janë kryer inventarizimet, pra nuk janë identifikuar objekte, troje e asete të tjera, që ka sjellë si pasojë përdorimi e paligjshëm me ndërtime apo me ushtrime aktiviteteve të ndryshme si lavazhe etj, dhe përdorim për banesë përdorim të jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie nga persona të ndryshëm të sipërfaqes prej 21420 m<sup>2</sup> truall në pronësi të Bashkisë me 1487 m<sup>2</sup> ndërtesa dhe 239 apartamenteve, që kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë dhe buxhetin e shtetit prej **50,716 mijë lekë** për shfrytëzim dhe përdorim të jashtë ligjshëm dhe pa titull pronësie; si dhe Nuk janë bërë llogaritjet për të ardhurat e munguara dhe dëm ekonomik për 4 pallate të zaptuara me sipërfaqe truall 1624 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 1516 m<sup>2</sup> të zëna forcërisht dhe për 5 pallate me sipërfaqe truall 2476 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 2111 m<sup>2</sup>, për shkak të mungesës së identifikimit të inventarizimit të personave nga bashkia që i përdorin jashtë ligjit, shtuar dhe nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën korrik 2013-dhjetor 2014 të sipërfaqes prej 74 ha kullotë, janë krijuar të ardhura të munguara dhe dëmi ekonomik na vlerën prej **888,000 lekë**, llogaritur, për të cilën bashkia ti llogarisë e arkëtojë këto të ardhura.

-Për veprime në kundërshtim me ligjin Ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit” e ndryshuar me VKM nr. 88, datë 07.02.2012, VKM nr. 139, datë 22.02.2012, VKM nr. 345, datë 09.05.2012 dhe VKM nr. 314, datë 13.3.2013, ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe ligjin nr. 8420, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. **të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,699,200 lekë (1191 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj).**

- Pasi në referim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, për përcaktimin e tarifës dysheme për pasuritë shtetërore, vlera e qirasë mujore përllogaritet: **“Për truallin e lirë, tarifa dysheme e qirasë është 100 lekë/m<sup>2</sup> në muaj”, mosveprim ky i cili ka sjellë pasoja financiare duke krijuar të ardhura të munguara për Bashkinë Kukës në vlerën prej 5,805,000 lekë (3225 m<sup>2</sup> truall x 100 lekë/m<sup>2</sup> x 18 muaj).**

**5. Për z. F.T,** në cilësinë e hartuesit të fondit limit, dhe në cilësinë e anëtarit të KVO-së pasi në tenderat e zhvilluar me objekt:

**1-** “Blerje materiale ndërtimi për shërbime të ndryshme për Bashkinë Kukës”, me fond limit 2,999,985 lekë dhe “Materiale për dekorin e Vitit të Ri 2014” nuk ka asnjë të dhënë se si kanë dalë çmimet për të cilat është llogaritur fondi limit, në

kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu II, “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2.

2- “Blerje veshje dhe vegla pune për nevojat e Bashkisë Kukës”, me fond limit 1,659,250 lekë, “Blerje materiale për shërbime të ndryshme”, me fond limit 3,000,000 lekë, “Blerje dru zjarri për vitin akademik 2013 -2014 për institucionet në varësi të bashkisë Kukës”, me fond limit 3,300,000 lekë, “Dekori i Vitit të Ri 2015”, me fond limit 1,543,400 lekë, nuk ka asnjë dokumentacion se si është llogaritur fondi limit si dhe nuk ka kërkesë për to, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu II, “Rregullat e përgjithshme të prokurimit”, pika 2, për tenderim me objekt “Blerje dru zjarri për vitin akademik 2013-2014 për institucionet në varësi të bashkisë Kukës” nuk ka asnjë dokumentacion për kërkesat sipas institucioneve, për tenderim me objekt “Shërbimin e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së varrezave publike”, Kukës”, me fond limit 1,660,400 lekë, në llogaritjen e shërbimit ruajtje objekti nuk ka asnjë argumentim se si ka dalë vlera dhe sa roje duhen në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i Procedurave”, pika 1.

4- “Blerje konteniere mbetjesh urbane” me fond limit 3,000,000 lekë, KVO duhej të kishte klasifikuar OE “B...”shpk dhe të skualifikonte OE “L...” shpk dhe “Proqual” shpk. Mosveprimi i KVO-së sipas kërkesave të kualifikimit të DT të AK, **ka shkaktuar dëm ekonomik prej 190,000 lekë.**

5- “Blerje pjesë ndërrimi (goma, lubrifikant, etj), me fond limit 3,499,900 lekë nga auditimi i procedurave rezulton se ky tender duhej të anulohet nga ana e KVO, pasi OE pjesëmarrës në të nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit. Vlerësimi i KVO-së në këtë mënyrë ka shkaktuar dëm ekonomik në shumën **282,750 lekë.**

6- Në 4 tenderat e zhvilluar me objekt: “Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të qytetit Kukës, me urdhër prokurimi nr. 12, datë 05.06.2014 dhe fond limit 24,005,266 lekë, nga auditimi rezultoi se OE “Xh...” shpk me vlerë të ofertës 19,066,635 lekë, është s`kualifikuar nga tenderi, pasi vërtetimi i taksave vendore të vitit 2012, është mbi tre muaj nga data e hapjes së tenderit, në kundërshtim me kërkesat e dokumenteve të tenderit, pasi kriteret e veçanta për kualifikim nuk e kanë këtë kërkesë e për rrjedhojë ky OE, nuk duhej të s`kualifikohet, por duhej të shpallej fitues mbas tërheqjes nga gara të OE “N...” shpk. Veprimi i KVO **ka shkaktuar dëm ekonomik në shumën 800,477 lekë.**

6. *Për z. L.D*, në cilësinë e kryetarit të KVO-së, dhe të Drejtorit Ekonomik, pasi në tenderat e zhvilluar me objekt:

1- “Blerje konteniere mbetjesh urbane” me fond limit 3,000,000 lekë, KVO duhej të kishte klasifikuar OE “B...”shpk dhe të skualifikonte OE “L...” shpk dhe “Proqual” shpk. Mosveprimi i KVO-së sipas kërkesave të kualifikimit të DT të AK, **ka shkaktuar dëm ekonomik prej: 190,000 lekë.**

